



USHTRIA



Viti i 77-të i botimit Nr. 13 (827868)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 29 mars 2024

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: Dyfishim i pagave për efektivët e FA-së në misionin e KFOR-it në Kosovë



» faqe 3

Gjeneralmajor Lisa Hou, komandantja e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, vizitë pune në SHP dhe AFA

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji priti në një takim të veçantë komandanten e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, gjeneralmajor Lisa J. Hou.

Gjeneral Kingji, pasi i uroi mirëseardhjen gjeneral Hou, vlerësoi bashkëpunimin me Gardën Kombëtare të New Jersey-it dhe mbështetjen e kontributin që japin SHBA-të nëpërmjet programeve të partneritetit dhe bashkëpunimit, në ndihmë të përmirësimit të kapaciteteve të Forcave të Armatosura. Takimi ndërmjet gjeneralmajor Kingjit dhe gjeneralmajor Lisa Hou-t u fokusua në marrëdhëniet dypalëshe të bashkëpunimit ushtarak. Gjeneral Kingji ofroi një panoramë të zhvillimeve të fundit në Forcat e Armatosura të RSH, duke u ndalur në projektet e modernizimit, përmirësimin e kuadrit ligjor, rishikimin e dokumenteve strategjike, kontributin në misionet e operacionet e drejtuara nga NATO, BE dhe OKB, si dhe bashkëpunimin në fushën e stërvitjes dhe trajnimit të përbashkët.

Në vijim, u trajtuan disa nga arritjet e vitit 2023 në kuadër të bashkëpunimit të FARSH-së me Gardën Kombëtare të New Jersey-it, dhe aktivitetet e planifikuara për vitin 2024, duke vënë theksin në thellimin e bashkëpunimit në interes të trajnimit të personelit kryesisht në përdorimin e teknikës së re të armatimit, mbrojtjes kundër armëve të dhëmbitura në masë, në fushën e zbulimit, si dhe në përmirësimin e të gjithë procesit të mirëmbajtjes logjistike në Forcat e Armatosura.

Gjeneralmajor Hou gjithashtu vlerësoi bashkëpunimin ushtarak dypalësh si një ndër partneritetet më të suksesshme që ka Garda Kombëtare e New Jersey-it, siguroi rritjen e mbështetjes së mëtejshme në fushat në të cilat Forcat e Armatosura kanë nevojë. Më tej, gjeneralmajor Lisa Hou, komandantja e Gardës Kombëtare të New Jersey-it (GKNJ), u prit në një takim pune nga gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj, zëvendëskomandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura.



Në takimin e zhvilluar gjeneral brigade Nuredinaj vlerësoi kontributin e GKNJ për zhvillimin e trupës së nënoficerëve, hartimin e kurrikulave dhe rregullores së nënoficerit të FARSH.

Gjithashtu, gjeneral brigade Nuredinaj falënderoi gjeneralmajor Hou-n, për bashkëpunimin e vazhdueshëm me gardën e New Jersey-it në fushën e arsimit, trajnimit, si dhe të shkëmbimit të eksperiencës në zhvillimin e stërvitjeve.

Gjeneralmajor Hou vlerësoi bashkëpunimin e frytshëm me AFA-në, si dhe premtoi për më shumë kontribut në të ardhmen në fushën e arsimit, trajnimit dhe stërvitjes.

Gjeneralmajor Ilir Xhebexhia priti shefin e Shtabit të Ushtrisë Italiane, gjenerallejtënant Carmine Masiello

Në Komandën e Forcës Tokësore, shefi i Shtabit të Ushtrisë Italiane gjenerallejtënant Carmine Masiello zhvilloi një vizitë zyrtare në kuadër të planit të bashkëpunimit dypalësh ushtarak me FA-të italiane për vitin 2024. Gjatë takimit komandanti i Forcës Tokësore gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, pasi i uroi mirëseardhjen mikut italian, vlerësoi rolin e Italisë si partner strategjik, bashkëpunimin ushtarak midis dy vendeve në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë, e fokusuar kjo në fushën e edukimit, trajnimit dhe stërvitjeve. Gjithashtu gjeneralmajor Xhebexhia vlerësoi rolin e Forcave të Armatosura italiane në kontributin e mbështetjen e dhënë për FARSH-në, si pjesë e misioneve të KFOR-it, në Kosovë dhe eVA, Bullgari. Nga ana e tij shefi i Shtabit të Ushtrisë Italiane, gjenerallejtënant Masiello vlerësoi mikpritjen dhe e siguroi komandantin se do ta rrisin më tej bashkëpunimin ushtarak si dy vende anëtare të NATO-s në drejtim të trajnimit e stërvitjes së trupave si dhe në forcimin e sigurisë dhe paqes në rajon. Më tej delegacioni italian, me anë të një brifingu të mbajtur nga shefi i Shtabit të FT-së, kolonel Beqir Tafili, u njoh me misionin, detyrat, strukturën e Forcës Tokësore si dhe planet e bashkëpunimit midis Forcës Tokësore shqiptare dhe Ushtrisë Italiane për vitin 2024.



Gjeneralmajor Arben Kingji priti gjenerallejtënant Carmine Masiello

SHSHPFA, gjeneralmajor Arben Kingji priti në takim shefin e Shtabit të Forcave Tokësore Italiane, gjenerallejtënant Carmine Masiello, me të cilin biseduan mbi bashkëpunimin dypalësh ushtarak, me synim përforcimin në të ardhmen në fushat me interes reciprok, në ndihmë të rritjes së kapaciteteve dhe aftësive operacionale të Forcave të Armatosura.

Në këtë takim SHSHPFA, gjeneralmajor Arben Kingji shprehu mirënjohjen për mbështetjen dhe kontributin që Italia ka dhënë në arsimit, trajnim, stërvitje, si dhe gjatë angazhimeve në misione të përbashkëta e nisma rajonale.



KLSM-14, viziton jugun e Shqipërisë

Në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë vijon programin Kursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen, kursi më i lartë në piramidën e arsimit ushtarak me pjesëmarrjen e ushtarakëve dhe civilëve të nivelit të lartë nga institucionet e sigurisë në vend, vendet e NATO-s dhe ato partnere. Në kuadër të programit "Team Building", grupi mësimor KLSM-14 zhvilloi takime në njësi administrative me rëndësi dhe vizita kulturore dhe historike në rajonin jug-perëndimor të Shqipërisë. Gjatë vizitës në Bashkinë Fier, në takimin e zhvilluar në sallën e Këshillit Bashkiak nga nënkryetari z. Andius Olldashi u bë prezantim me karakter njohës dhe përmbledhës për profilin e Bashkisë Fier, vlerat dhe resurset historike, kulturore, ekonomike dhe turistike të saj. Më pas stafi drejtues dhe grupi i KLSM-14, vizituan Muzeun Historik të Fierit si dhe Parkun Kombëtar Arkeologjik të Apolonisë, Fier. Në vijim të programit u realizua takim me kryetarin e Bashkisë së qytetit të Vlorës, z. Ermal Dredha, gjatë të cilit pjesëmarrësit u njohën me organizimin, angazhimet aktuale të Bashkisë, duke veçuar zhvillimet në turizëm dhe bashkëpunimin me Forcat e Armatosura. Në sesionin e pasdites pjesëmarrësit e KLSM-14 vizituan Muzeun Kombëtar të Pavarësisë, ku u njohën me vlerat historike të qytetit të Vlorës. Ndajesa e radhës ishte në Bashkinë e Sarandës, ku stafi drejtues dhe grupi KLSM-14 u pritën nga z. Oltion Çaçi, kryetar i Bashkisë Sarandë. Gjatë takimit ai i njohu pjesëmarrësit me vlerat historike, ekonomike dhe turistike të këtij qyteti. Programi vijoi me vizita në Parkun Kombëtar të Butrintit, Syrin e Kaltër (monument natyre) dhe në Kalanë e Gjirokastrës, ku pjesëmarrësit panë nga afër trashëgiminë kulturore, arkeologjike, mjedisore dhe turistike të vendit tonë.



Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: Dyfishim i pagave për efektivët e FA-së në misionin e KFOR-it në Kosovë

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi ka bërë të ditur se Shqipëria dyfishoi pagat e efektivëve të saj që shërbejnë në kuadër të KFOR-it, në Kosovë.

“Dyfishimi i pagave për efektivët e Forcave të Armatosura në misionin e KFOR-it në Kosovë tregon qartë angazhimin tonë për të vlerësuar punën e tyre në mënyrë të drejtë”, - u shpreh Ministri Peleshi, duke shtuar se angazhimi i ushtarëve të tyre në misionet ndërkombëtare është thelbësor për sigurimin e paqes dhe stabilitetit në rajon.

“Angazhimi dhe përkushtimi i efektivëve tanë në 8 misione ndërkombëtare të rëndësishme për sigurimin e paqes dhe stabilitetit rajonal është thelbësor. Vazhdojmë të punojmë për të siguruar një rritje të përgjithshme të pagës për të gjithë personelin tonë në misione. Shqipëria, eksportuese e paqes dhe aleate dinjitoze në NATO”, - theksoi ministri Peleshi.



Delegacioni i Komandës së Forcës Tokësore, vizitë në FSK

Një delegacion i Komandës së Forcës Tokësore, i kryesuar nga komandanti i FT-së, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia zhvilloi një vizitë dy ditore në Kosovë.

Kjo vizitë zhvillohet në kuadër të matricës së aktiviteteve kryesore të FT-së, për vitin 2024 si dhe Planit të Bashkëpunimit Ushtarak midis Forcës Sigurisë Kosovës dhe Forcës Tokësore.

Gjatë vizitës, delegacioni i FT-së i FARSH-së kreu një vizitë zyrtare në komandën e Forcës Tokësore të FSK-së në Istog, ku u pritën nga komandanti i KFT-së, gjeneral brigade Hysen Dreshaj.

Gjatë takimit, gjeneral brigade Dreshaj njohu delegacionin me arritjet dhe sfidat e KFT-së në drejtim të rritjes së kapaciteteve luftarake si dhe u diskutuan mundësitë dhe rrugët për të rritur më tej bashkëpunimin midis dy forcave, i fokusuar ky në trajnimet e stërvitjet e përbashkëta.

Në përfundim të takimit, komandanti i Forcës Tokësore të FARSH-së, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, shprehu falënderimet e tij për pritjen e ngrohtë dhe theksoi gatishmërinë e Forcës Tokësore në rritjen e bashkëpunimit në fusha me interes të përbashkët, për rritjen e kapaciteteve luftarake dhe kontributin e tyre në të mirën e të dy vendeve dhe interesit të përgjithshëm në të mirë të paqes dhe sigurisë në rajon.

Më tej, vizita vijoi në Komandën Rajonale Perëndimore në “Camp Villaggio Italia” në Pejë, aty ku efektivat e kontingjenteve të FT-së kryejnë misionin në përbërje të operacionit ushtarak të



NATO-s, KFOR.

Pas pritjes zyrtare gjeneralmajor Xhebexhia zhvilloi takim me komandantin e bazës, kolonel Francesco Ferrara, i cili i shprehu falënderimet për kontributin që FARSH po jep në KFOR, si dhe punën e shkëlqyer që po kryejnë personeli shqiptar në mision.

Më pas nga zëvendëskomandanti i bazës, nënkolonel Besnik Fana u njoh me situatën e përgjithshme, punën dhe kontributin e kontingjenteve të Forcës Tokësore me mision KFOR, Pejë, si dhe zhvilloi takim me efektivët shqiptarë pjesëmarrës në misione.



Shqipëria në krye të SEEBRIG



Prej muajit gusht 2023, Shqipëria drejton Brigadën e Evropës Juglindore (SEEBRIG), një nga iniciativat rajonale të ministrave të Mbrojtjes së Evropës Juglindore (SEDM). Nga Kumanova në Maqedoninë e Veriut, komandanti i South Easter Europe Brigade (SEEBRIG), gjeneral brigade Bilbil Bitri sqaron se: “SEEBRIG, në komponentin e tij ushtarak u krijua për të rritur nivelin e bashkëpunimit ushtarak dhe për të forcuar marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë midis vendeve pjesëmarrëse”.

Kjo iniciativë sot përbëhet nga gjashtë shtete: Shqipëria, Bullgaria, Greqia, Maqedonia e Veriut, Rumania dhe Turqia. Kjo është hera e dytë që në krye të SEEBRIG është një komandant, që vjen nga radhët e Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Komandant i Brigadës së SEEBRIG, gjeneral brigade Bilbil Bitri sqaron më tej se:

“Përveçse detyrim, është një mundësi për të treguar atë që Shqipëria e ka treguar më së miri që pas rënies së Murit të Berlinit, frymën e bashkëpunimit rajonal, frymën e një stabiliteti dhe paqeje dhe idenë për të dakordësuar dhe kontribuar në iniciativat e tilla, që forcojnë jo vetëm bashkëpunimin, por krijojnë terrenin për një zhvillim paqësor të rajonit”.

Sipas gjeneral brigade Bilbil Bitrit, për Shqipërinë është një ko incidencë fantastike që në 15 - vjetorin e Anëtarësimit në NATO, në të njëjtën kohë jo vetëm kontribuon drejtpërdrejt në NATO, por kontribuon gjithashtu edhe përmes iniciativës rajonale për paqen dhe sigurinë në rajon e përtej tij.

Shqipëria do të mbajë drejtimin e Iniciativës së Ministrave të Mbrojtjes së Evropës Juglindore për një afat trevjeçar.



Personeli ushtarak i Detashmentit të Mjeteve Ajrore pa pilot përfundon me sukses trajnimin për përdorimin operacional të dronëve "TB2 Bayraktar"

Oficerët, nënofficerët dhe ushtarët profesionistë të Detashmentit të Mjeteve Ajrore pa pilot u trajnuan për 4 muaj në Keshan të Turqisë dhe sot janë në gatishmëri operacionale si pilotë, teknikë, mekanikë, elektroteknikë, dhe operatorë ngarkesash, duke rritur aftësitë dhe zgjeruar kapacitetet operacionale të Forcës Ajrore dhe të Forcave të Armatosura të RSH.

Gjatë kësaj periudhe 4 - mujore, ushtarakët e FARSH treguan seriozitet dhe përkushtim maksimal që kulmoi me certifikimin e suksesshëm të personelit shqiptar. Në ceremoninë e organizuar me rastin e përfundimit të trajnimit, drejtori i Qendrës së Trajnimeve z. Taner Dogruer, në fjalën e tij përshëndetëse theksoi përkushtimin dhe seriozitetin e kontingjentit, duke e vlerësuar si një ndër grupet më të mira të huaja që janë arsimuar e trajnuar në këtë qendër.

Nëntoger Dorjan Lico nga grupi Pilot, tetar Rakip Shehu nga grupi elektronik, nëntetar Erges Rama nga grupi mekanik dhe ushtar II Stellina Fejzollu nga grupi operatorët e ngarkesave u vlerësuan si kursantët më të mirë. Në këtë event të rëndësishëm për FARSH-në morën pjesë ambasadorja e Republikës së Shqipërisë në



Turqi, znj. Blerta Kadzadej, atasheu ushtarak në Turqi, kolonel Majlinda Sallaku, si dhe të ftuar të tjerë nderi. Në fjalën përshëndetëse të rastit, komandanti i Detashmentit, major Eljo Buçka, falënderoi ministrin e Mbrojtjes, shefin e Shtabit të FARSH-së, komandantin e Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ferdinand Dimo, si dhe stafin e qendrës së trajnimeve në Keshan, për vlerësimin dhe mbështetjen e pakursyer në drejtim të kontingjentit shqiptar.

Në përfundim të kursit u bë ndarja e certifikatave përkatëse dhe fotot e rastit.

Gjeneral brigade Ferdinand Dimo, viziton Shkollën e Mbrojtjes Kundërajrore dhe Brigadën e Mbrojtjes Ajrore në Bazën Ushtarake të Fort Still

Në kuadër të familjarizimit me kurset institucionale BOLC dhe CCC të oficerit të AKA si dhe njohja nga afër me sistemet kundërajrore VSHORAD, M-SHORAD dhe LORAMID, Komandanti i FAj. gjeneral brigade Ferdinand Dimo, realizoi një vizitë zyrtare në Shkollën e Mbrojtjes Kundërajrore dhe Brigadën e Mbrojtjes Ajrore në Bazën Ushtarake të Fort Still, Oklahoma, në SHBA.

Gjatë kësaj vizite, ekipi shqiptar pa nga afër disa sisteme të mbrojtjes kundër ajrore të ekspozuara për efekt mësimor dhe stërvitor si dhe ndoqi nga afër një seancë stërvitore të efektivit të baterisë "Avenger", të cilat ishin të dislokuara në Bazën Fort Still.

Në këtë vizitë, komandanti i FAj. gjeneral brigade Ferdinand Dimo, u prit nga komandanti i shkollës dhe brigadës së AKA dhe komandantin e bazës Fort Sill, gjeneral brigade Curtis King.

Gjeneral brigade King, pasi shprehu vlerësimet dhe konsideratat për zhvillimet, konfirmoi gatishmërinë dhe mbështetjen e strukturës që ai drejton në të gjitha fazat që do të kalojë ngritja e Batalionit të Mbrojtjes Ajrore. Ai ofroi gjithashtu dhe asistencë për personelin shqiptar në ndjekjen e të gjitha kurseve të drejtimit dhe ato të mirëmbajtjes.



Kundëradmiral Adnan Agastra merr pjesë në ceremoninë e 50 - vjetorit të Krijimit të Bazës Detare të Shëngjinit

Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnan Agastra, mori pjesë në ceremoninë e 50 - vjetorit të Krijimit të Bazës Detare të Shëngjinit.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast ishin të pranishëm gjithashtu personalitete të pushtetit vendor e lokal, kryetari i Bashkisë Lezhë, z. Pjerin Ndreu, kryetari i Shoqatës Detaria Shqiptare, ish - komandantë të Forcës Detare/Rojës Bregdetare, ish - efektivë dhe punonjës civilë që kanë shërbyer në Bazën Ushtarake Detare Shëngjin, Qendra e Personel Rekrutimit me personelin e saj, ku shpalosën mundësitë dhe informacionin ndaj të rinjve për t'u bashkuar në radhët e Forcave të Armatosura të RSH, si një mundësi për të ardhmen. Gjatë ceremonisë u kujtuan personeli ushtarako - detar dhe punonjësit civilë që kanë shërbyer ndër vite në bazën detare si dhe kanë kontribuar për komunitetin e qytetit të Shëngjinit

Ceremonia vijoi me dhënie të certifikatave të mirënjohjes për kontributin e dhënë në Forcën Detare/Rojën Bregdetare nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji, komandanti i Forcës Detare/Rojës Bregdetare kundëradmiral Adnan Agastra, si dhe nga kryetari i Bashkisë Lezhë, zoti Pjerin Ndreu.

Ceremonia u përmbyll me emërtimin e sheshit në qytetin e Shëngjinit me emrin "Marinari", si dhe u vendos busti me të njëjtin emër, financuar nga kompania në fushën e Sigurimeve "Sigal Uniqa Group Austria", përfaqësuar nga CEO z. Avni Ponari.



Toga EOD, me mision në Letoni, merr pjesë në stërvitjen "Cristal Arrow"

Toga EOD, me mision në Letoni, mori pjesë në stërvitjen certifikuese të grup-batalionit, sipas sistemit "Combat Readiness Evaluation" (CREVAL) të NATO-s, të quajtur "Cristal Arrow".

Në këtë stërvitje morën pjesë të gjitha nënrepartet e grup-batalionit dhe Brigadës Letoneze.

Fokusi kryesor i komandantit të grup-batalionit për togën EOD, ishte mbështetja me shërbime EOD, për të gjitha nënrepartet e grup-batalionit, gjatë të gjitha fazave të zhvillimit të stërvitjes, duke qenë se territori i stërvitjes në kamp Adazi është shumë i kontaminuar (ndotur) me prani apo mbetje municionesh.

Gjatë gjithë fazave të realizimit të stërvitjes, toga EOD realizoi në total 7 detyra, duke pastruar dhe neutralizuar në total 13 municione të kalibrave të ndryshëm, duke mbështetur kështu të gjitha nënrepartet e grup-batalionit gjatë gjithë fazave të zhvillimit të kësaj stërvitjeje.

Në përfundim të kësaj stërvitjeje, Komandanti i grup-batalionit, nënkolonel Jonathan COX shprehu përshtypjet më të mira për punën e bërë nga toga EOD dhe si rrallë herë vlerësoi 5 efektivë nga 1 nënrepart i vetëm (toga EOD) me certifikatë vlerësimi për punën shumë të mirë të bërë gjatë kësaj stërvitjeje.





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

"Gjyshi me libra"



Nipi: - Gjysh, si keni jetuar më herët, në një jetë shumë më të vështirë se sa ne?

Gjyshi: - Ne kemi qenë të bekuar biri im, provë për këtë është jeta jonë. Pas shkollës, i kemi bërë detyrat vetëm, dhe gjithmonë kemi shkuar të luanim në lëndina deri në perëndim të diellit. Kemi luajtur me miq të vërtetë, jo me miq në internet. Kur kishim etje, kemi pirë ujë burimi, jo ujë në shishe plastike. Nuk jemi sëmurrur kurrë, kur pinim në të njëjtën gotë me shokët tanë. Nuk i ka ndodhur asgjë këmbëve tona edhe pse ecnim zathur.

Nuk kemi përdorur kurrë përbërës kimik për të qenë të shëndetshëm. I kemi krijuar me duart tona lodrat me të cilat luanim. Prindërit tanë nuk ishin të pasur, por na kanë dhënë shumë dashuri, dhe jo video-lojëra që të rrinim urtë. Vërtet nuk kemi patur kurrë telefona, DVD, Play Station, Xbox, videolojëra, kompjuter personal, internet... por kemi patur shokë dhe miq të vërtetë. Shkonim tek shtëpia e shokut pa ftuar dhe shijonim bukën e tij me vaj dhe sheqer.

Kushërinjtë i kishin shtëpitë afër njëri-tjetrit për të shijuar kohën bashkë dhe për t'iu gjendur njëri-tjetrit pranë në çdo hall. Vërtet jemi në foto bardhezi, por në ato foto kemi kujtime plot ngjyra. Jemi një brez unik dhe i mirë kuptueshëm, sepse jemi brezi i fundit që ka dëgjuar prindërit... dhe jemi brezi i parë që ka dëgjuar fëmijët e tij.

Nipi: - Gjysh, kam provuar të lexoj libra sikurse ti, por nuk mund t'i kuptoj ato, edhe atë çfarë e kuptoj e harroj sapo ta mbyll librin. Çfarë të mirash ka nga leximi i librit?"

Gjyshi, me qetësi ndaloi së mbushuri sobën me qymyr dhe iu drejtua nipit:

- Merre këtë shportë qymyri, mbushë në lumë me ujë dhe ma sill prapë! Djaloshi veproi si i tha ai, por i tërë uji i rrodhi nga shporta para se të vinte në shtëpi. Gjyshi qeshi dhe i tha:

- Duhet të ecësh pak më shpejt herën tjetër, e dua shportën me ujë.

Kësaj radhe djaloshi vrapoi shpejt, por përsëri shporta ishte e zbrazët para se të kthehej në shtëpi. Me gjysmë fryme i tha gjyshit se ishte e pamundur të mbushte ujë me shportë dhe shkoi ta merrte një kovë. Plaku i tha:

- Nuk dua një kovë ujë, por dua një shportë ujë. Ti vetëm nuk provon sa duhet, dhe doli jashtë ta shikonte djaloshin tek po provonte përsëri.

Kësaj radhe, djaloshi e kuptoi se ishte e pamundur, por dëshironte t'i tregonte gjyshit të tij se edhe nëse do të vraponte sa më shpejt që të mundte nuk do t'ia arrinte, uji do të rridhte para se të kthehej në shtëpi.

Djaloshi, përsëri e zhyti shportën në lumë dhe vrapoi shpejt, por kur arriti të gjyshi i tij shporta ishte e zbrazët. Me gjysmë fryme tha:

- E sheh gjysh, është e padobishme. Plaku ia ktheu:

- Shikoje shportën, djaloshi shikoi shportën dhe për herë të parë e vërejti se shporta ishte ndryshe, ishte transformuar nga një shportë e vjetër e ndyrë në një shportë të pastër, brenda dhe jashtë.

- Bir, kjo ndodh kur e lexon librin, mund të mos kuptosh dhe të mos mbash mend asgjë, por kur e lexon atë, do të ndryshosh brenda dhe jashtë. Kjo është puna e germave të arta në jetët tona.

Super heronjtë e vërtetë në këtë botë jo shumë të mirë, janë gjyshërit, ata na ndihmojnë të mësojmë se si të mbijetojmë dhe të argëtohemi edhe kur gjithçka po shkatërrohet. Thuhet gjithashtu se fëmijët e rritur nga gjyshërit nuk kanë nevojë për terapi. Një telefonatë me engjëjt e mëdhenj mund t'i ndihmojë ata të përballojnë sfidat me vendosmëri.

Le të marrim pak ndihmë nga njerëzit që kanë kënduar vargje për gjyshërit, për të ushqyer dashurinë dhe përpjekjet e këtyre engjëjve të mëdhenj.

“LIBRAT JANË THESARE TË VËRTETA DHE TË GJITHË DUHET T’I KËRKOJNË ATO. KUR NJË PERSON HAP LIBRA, AI GJEN THESARE MIRËSIE DHE MENÇURIE, QË BUROJNË NGA FAQET E SAJ SË BASHKU ME KËSHILLA TË MIRA DHE MËSIMET TË SHËNDOSHA. LIBRAT E MIRË JANË SHTËPIA E DRITËS QË NDRIÇON MENDJET, FAMILJET, SHKOLLAT DHE SHOQËRITË TONA. ATA EDUKOJNË ZEMRAT, PËRMIRËSOJNË PERSONAZHET, NA NGUSHËLLOJNË DHE NA KËNAQIN.

Në këtë kulturë të madhe të vjetër perëndimore, mësuesit tanë të moshuar janë librat. Librat janë gjyshi ynë!

Të moshuarit dhe të rinjtë kanë diçka të përbashkët që i justifikon ata të mbeten vetëm së bashku. Prandaj, ekziston një lidhje e padukshme midis gjyshërve dhe nipërve. Kujtimet më të forta të fëmijërisë janë aroma e shtëpisë së gjyshit. Të gjithë jemi gjykuar dhe qortuar nga prindërit tanë, por gjyshërit qëndruan si mburoja për të na shpëtuar nga këto sharje dhe gjykime dhe për të rritur besimin tonë.

Librat janë thesare të vërteta dhe të gjithë duhet t'i kërkojnë ato. Kur një person hap libra, ai gjen thesare mirësie dhe mençurie, që burojnë nga faqet e saj së bashku me këshilla të mira dhe mësimet të shëndosha. Librat e mirë janë shtëpia e dritës që ndriçon mendjet, familjet, shkollat dhe shoqëritë tona. Ata edukojnë zemrat, përmirësojnë personazhet, na ngushëllojnë dhe na kënaqin.

Leximi i librave është një burim për të mposhtur mërzinë dhe për të mposhtur vetminë. Është gjithashtu një burim për të rifilluar ditën me një forcë dhe entuziazëm të ri. Për trupin e shëndoshë, një mendje e ushqyer është e rëndësishme dhe për një mendje të ushqyer, leximi i librit është i rëndësishëm. Leximi i librave, zakoni më i mirë që mund të zhvillojë

Zakoni i të lexuarit është një nga cilësitë më të mira që një person mund të posedojë. Librat dihet që janë shoku juaj më i

mirë për një arsye. Pra, është shumë e rëndësishme të krijoni një zakon të mirë të leximit. Të gjithë duhet të lexojmë çdo ditë për të paktën 30 minuta për të shijuar frytet e ëmbla të leximit. Është një kënaqësi e madhe të ulesh në një vend të qetë dhe të shijosh leximin. Leximi i një libri të mirë është një nga përvojat më të këndshme.

Unë mund ta quaj një “perandori libri” shtëpinë e gjyshit. Të jetoje apo të shkoje në shtëpinë e tij, kontakti i parë ishte me librin. Libri ishte objekti më i privilegjuar i asaj shtëpie. Kishte libra shumë të vjetër, një pjesë e të cilëve datonin qysh në kohën e stërgjyshërve tanë. Ai kishte një bibliotekë shumë të madhe. Shumica ishin të sistemuar. Vetëm kuzhina dhe korridorin nuk kishin libra. Bodrumi ishte me libra. Dhoma e gjumit, të cilën e quante studio dhe flinte bashkë me gjyshen, kishte vetëm një dritare të madhe, ndërkohë që tre faqe muri ishin me libra. Biblioteka ishte shumë e pasur.

Mendoj se në një farë mënyrë gjyshi ka diktuar të ardhmen tonë profesionale. Unë jam rritur mes librash. Ne na abononte gjyshi qysh të vegjël tek të gjitha revistat e kohës sipas moshës. Libri kishte një vlerë të jashtëzakonshme. Aq ndikim ka pasur ai tek ne, sa një shprehje e Sartrit do i shkonte më së miri kujdesit të familjes për librat: “Mënyra si gjysh im kujdeset për librat, i pastronte e i sistemonte, instinktivisht ne si fëmijë na bënte të kuptonim se nga këto libra varej fati i familjes sonë”.



KOLONEL HYSNI GJERGJI

DRON dhe LAZER, sfidë dhe mundësi për Forcën Ajrore

Apo zëvendësohen pilotët nga dronët? A po zëvendësohen raketat dhe artileria kundërajrore me rrezet lazer? Britania demonstroi, më 14 mars të 2024, një armë të re lazer, me të cilën ushtria e saj mund të sigurojë mbrojtje vdekjeprurëse raketore ose avionësh me rreth 13 dollarë për një të shtënë, duke kursyer potencialisht dhjetëra miliona dollarë mbi koston e përgjuesve të raketave që përdoren tani. Përpara se të marrim në analizë nëse dronët do të zëvendësojnë pilotët, është e rëndësishme të kuptojmë teknologjinë dhe aftësitë që posedojnë dronët. E rritur vrullshëm kjo teknologji solli në tryezën e diskutimit deri në mundësinë e zëvendësimit të faktorit njeri në pilotim të mjeteve ajrore. I lindur si domosdoshmëri në luftë, për të mbrojtur jetën e pilotëve në misione të rrezikshme, me kalimin e viteve rezultoi efikas, i saktë dhe më i leverdishëm përveç sigurisë kombëtare edhe për industrinë e prodhimit në shumë fusha të ekonomisë shkencës etj. Shmangia e ndjeshmërive njerëzore, si frika, euforia, shëndeti i pilotit, në një mision luftarak, të cilat me dronin u zhdukën. Droni dhe lazeri godasin pa emocion, pa keqardhje, pa frikë, nuk lodhen, nuk kanë nevoja personale dhe shëndetësore dhe mund të qëndrojnë mbi 24 orë në ajër. Dronët janë të pajisur me një sërë sensorësh, duke përfshirë GPS, akselerometra, xhiroskopë dhe magnetometra, duke u mundësuar atyre të kenë pozicionim të saktë dhe stabilitet gjatë fluturimit.

Dronët dhe laseri shpesh janë të pajisur me kamera me rezolucion të lartë dhe sisteme imazherie, të cilat i lejojnë ata të kapin imazhe dhe video të detajuara nga kënde dhe lartësi të ndryshme pavarësisht motit.

Rritja e numrit dhe llojeve të dronëve në aviacion ka ndezur gjithashtu diskutime rreth zëvendësimit të mundshëm të pilotëve në të gjitha fushat e aviacionit. Është thelbësore të pranohet se dronët dhe pilotët mund të bashkëjetojnë dhe të bashkëpunojnë në mënyra dhe forma të tilla që rrisin efikasitetin, sigurinë dhe aftësitë e industrisë së aviacionit. Këtë mundësi nuk e ka piloti në ajër, ai është njeri dhe ka nevojat dhe veçoritë e tij biologjike, duke mos qenë efektiv si në orën e parë të fluturimit ashtu edhe në të 8-ën apo 10-ën. Megjithatë, kjo autonomi nuk është e plotë, pasi nga toka droni drejtohet nga njerëz dhe vendimi deri tani i përket njeriut. Ndërsa dronët ofrojnë përparime, pilotët njerëzorë sjellin aftësi, përvojë dhe ndërgjegjësim të pazëvendësueshëm për situatën në fushën e luftimit kryesisht. Pilotët zotërojnë aftësinë për të marrë vendime kritike, si dhe për t'iu përshtatur situatave të papritura, duke i dhënë përparësi sigurisë. Dronët vërtet shikohen si mjete dhe makina pa shpirt, pa zemër pa ndjenja, çka vihet re nga plejada e vjetër e pilotëve që iu takon të jenë krenarë dhe nostalgjikë për funksionimin e kësaj arme. Për më tepër, dronët mund të programohen që të fluturojnë në mënyrë autonome nëpër korridore të paracaktuara fluturimi, të



kryejnë detyra specifike dhe madje të shmangin pengesat, duke përdorur sistemet e zbulimit.

Sot është një realitet i ri dhe flota e dronëve po sfidon avionët me pilot. Luftërat e dy dekadave të fundit sollën në aviacionin luftarak një risi që kishte nisur nga lojërat e fëmijëve me avionë me telekomandë.

Ndërsa industria e dronëve dhe e lazerit ecën përpara, është thelbësore që pilotët dhe operatorët e tyre të punojnë së bashku në një mënyrë bashkëpunuese. Pilotët mund të specializohen në operacionet me dron, të analizojnë të dhënat e mbledhura nga dronët dhe të ofrojnë njohuritë e tyre të vlefshme. Ata gjithashtu mund të kontribuojnë në hartimin e rregulloreve, duke siguruar integritimin dhe funksionimin e sigurt të dronëve. Duke përqafuar potencialin e bashkëpunimit dronë-pilot, ne mund të zhblokojmë mundësitë e reja në industrinë e aviacionit. Së bashku, dronët dhe pilotët mund të revolucionarizojnë fotografimin nga ajri, zbulimin ajror, shpërndarjen e ngarkesave, inspektimin e infrastrukturës, reagimin ndaj emergjencave dhe shumë fusha të tjera. Ndërsa teknologjia vazhdon të përparojë, është thelbësore të njihet vlera

e dronëve dhe pilotëve, duke njohur pikat e tyre të forta përkatëse dhe duke i kombinuar ato për të mirën e aviacionit në tërësi.

Pra, le të përqafojmë potencialin e bashkëpunimit dronë-pilot dhe të punojmë së bashku për të formuar një të ardhme ku siguria, inovacioni dhe ekspertiza njerëzore do të fluturojnë. Dronët, të njohur gjithashtu si mjete ajrore pa pilot (UAV), kanë evoluar me shpejtësi nga të qenit lodra të thjeshta me telekomandë në një përfshirje të shpejtë në industri të ndryshme, përfshirë aviacionin. A do të zëvendësojnë dronët pilotët? Është e vërtete që janë shmangur orë të tëra fluturim për aftësim të një piloti, disa mijëra litra karburant dhe konsum ekonomik dhe i kohës. Kjo shpikje e re kërkon shumë më pak kohë, dhe më pak para për të qenë eficiente, çka e bën të pakthyeshëm këtë revolucionarizim, i cili nuk është vetëm ushtarak. Me përparimet në teknologjinë ushtarake dronët janë bërë më efikas, më të aftë për të kryer detyra komplekse dhe të pajisur me sensorë dhe kamera të avancuara, ndihmojnë në navigimin dhe mbledhjen e të dhënave rreth armikut, vendndodhjes, trupave, teknikës, si dhe të godasë me precizion të lartë. Dronët kamikazë janë një lloj predhe e precizionit të lartë, që nuk ka madje të nevojshëm as komandat për kthim.

Vitet e fundit, përdorimi i dronëve në aviacionin civil ka qenë në rritje, duke ofruar një gamë të gjerë aplikimesh si fotografimi ajror, dorëzimi i paketave, mbikëqyrja, operacionet e kërkimit dhe shpëtimit, madje edhe inspektimi i infrastrukturës. Këto përparime teknologjike kanë hapur një gamë të gjerë mundësish për përdorimin e dronëve në industri të ndryshme, përfshirë aviacionin me pilot. Kuptimi i aftësive të dronëve është thelbësor në vlerësimin e potencialit të tyre për të zëvendësuar pilotët në degë të caktuara të aviacionit. Le të hedhim një vështrim më të afërt në disa nga këto avantazhe:

Siguria e jetës së pilotit: Dronët mund të vendosen në situata që paraqesin rreziqe për pilotët njerëzorë, të tilla si misionet e kërkimit dhe shpëtimit në mjedise të rrezikshme ose inspektimi ajror i infrastrukturës, pasi mungon faktori njeri që i mbart këto ndjesi.

Kostoja: Krahasuar me avionët tradicionalë të drejtuar, dronët janë më ekonomikë për t'u operuar dhe mirëmbajtur, duke i bërë ata një opsion tërheqës për detyra të tilla si harta dhe fotografimi ajror, mbikëqyrja, zbulimi ushtarak, goditje objektivash deri tek monitorimi i bujqësisë. Më 7 mars 2024, Sekretari britanik i Mbrojtjes, Grant Shapps, teksa takoi Presidentin Zelenskyy në



Kiev, rriti mbështetjen për Ukrainën me një paketë të plotë prej 325 milionë sterlina për 10 000 dronë për Forcat e Armatosura të Ukrainës, për të ofruar aftësi të avancuara në Ukrainë gjatë vitit 2024. Ky numër kaq i madh shenjash ajrore me avionë të pilotuar, do të ishte i pabesueshëm disa vite më parë. Nëse do krahasonim kostot me F 16 dhe F 35 me këtë shumë parash Ukraina do të blinte 2 deri në 6 avionë të tillë, ndërsa do t'i duhej një kohë disa mujore ose vjeçare për të përgatitur pilotët.

Saktësia: Dronët e pajisur me sisteme të avancuara imazherie, mund të kapin të dhëna të detajuara me saktësi të lartë, duke mundësuar analizë dhe vendimmarrje më të mirë në fusha të tilla si ushtria, bujqësia, rilevimi i tokës dhe monitorimi i mjedisit dhe motit.

Qasja në zonat e largëta: Dronët mund të arrijnë në vende të largëta ose të paarritshme më lehtë sesa avionët me njerëz, duke i bërë ato mjete të pazëvendësueshme për detyra si monitorimi i armikut për një kohë të gjatë, reagimi ndaj fatkeqësive natyrore ose inspektimet e infrastrukturës.

Efikasiteti në kohë: Dronët mund të kryejnë detyra më shpejt sesa avionët me pilot, gjë që mund të zvogëlojë ndjeshëm kohën e reagimit në situata kritike luftarake po kështu edhe ndaj ndërhyrjeve të emergjencave mjekësore, nevojave civile industriale, bujqësore si dhe aksidenteve.

Ndërsa dronët ofrojnë përparësi të shumta, është thelbësore të merren parasysh kufizimet e tyre dhe nevoja e mundshme për ndërhyrje njerëzore në situata të caktuara. Pilotët luajnë një rol kritik në aviacion, pasi ekspertiza dhe aftësitë e tyre vendimmarrëse janë të paçmueshme në sigurimin e operacioneve të sigurta dhe efikase. Disa aspekte kryesore të rolit thelbësor të pilotit janë:

Planifikimi: Pilotët ndryshe nga dronët janë përgjegjës për hartimin e itinerareve të fluturimit, duke marrë parasysh kushtet e motit, rregulloret e hapësirës ajrore dhe për të garantuar sigurinë e fluturimit nga ngritja e deri në ulje.

Funksionimi i avionit: Pilotët janë trajnuar për të drejtuar sisteme të ndryshme të avionëve, për të monitoruar performancën e motorit dhe për të bërë rregullimet e nevojshme gjatë fluturimit. Pilotët kanë aftësi për t'iu përgjigjur urgjencave dhe situatave të papritura.

Ndërgjegjësimi për situatën: Pilotët vlerësojnë vazhdimisht mjedisin, duke përfshirë trafikun ajror, avionët përreth dhe rreziqet e mundshme. Ata marrin vendime të informuara bazuar në informacionin në kohë reale dhe i japin përparësi sigurisë në çdo kohë. Komunikimi: Pilotët komunikojnë me kontrollin e trafikut ajror, anëtarët e tjerë të ekuipazhit dhe personelin tokësor për të siguruar koordinim efektiv. Komunikimi i qartë dhe konciz është thelbësor për fluturime të sigurta dhe efikase. Gjykimi njerëzor dhe vendimmarrja: Pilotët zotërojnë aftësinë për të analizuar situata komplekse, për të vlerësuar rreziqet dhe për të marrë vendime kritike në kohë reale. Ata marrin parasysh faktorë të shumtë, duke përfshirë situatën në zonën e armikut të pakapshme nga dronët, sigurinë e pasagjerëve, kushtet e motit dhe performancën e avionit. Këto përgjegjësi nxjerrin në pah rëndësinë e pilotëve njerëzorë në aviacion, pasi ato sjellin një kombinim të aftësive, përvojës dhe përshtatshmërisë që teknologjia ende duhet t'i përsërisë plotësisht. Ndërsa dronët kanë aftësi të avancuara teknologjike, ata nuk mund të përsërisin vitet e trajnimit, përvojës dhe gjykimin njerëzor që pilotët sjellin në tryezë. Pilotët zotërojnë aftësi të të menduarit kritik, përshtatshmëri dhe vetëdije për situatën që janë thelbësore në skenarët komplekse të aviacionit. Rritja e dronëve nuk do të thotë fundi i pilotëve. Në vend të kësaj, ajo hap mundësi dhe role të reja për pilotët në industrinë e aviacionit. Pilotët mund të përshtaten dhe të specializohen në fusha të tilla si operimi me dron, analiza e të dhënave ajrore ose mbikëqyrja e misioneve autonome.

Megjithëse ka dronë autonomë, operatorët njerëzorë janë ende të nevojshëm për të mbikëqyrur dhe kontrolluar operacionet e tyre. Pilotët luajnë një rol vendimtar në planifikimin e misionit, duke analizuar të dhënat e mbledhura nga dronët dhe duke marrë vendime të informuara bazuar në atë informacion. Si çdo teknologji, dronët nuk janë të pagabueshëm. Ata mund të hasin keqfunksionime teknike ose të përballen me sfida të papritura gjatë fluturimit. Pilotët janë të pazëvendësueshëm në identifikimin dhe korrigjimin e këtyre çështjeve për të ruajtur funksionimin e tyre të sigurt.

Dronët nuk janë të dizajnuar për të zëvendësuar pilotët e linjave ajrore komerciale që merren me avionë të mëdhenj dhe sisteme komplekse. Rregulloret dhe standardet e sigurisë kërkojnë praninë e pilotëve të trajnuar dhe të aftë për të garantuar sigurinë e pasagjerëve në aviacionin komercial. Ndërsa dronët sjellin përfitime dhe përparime të shumta në aviacion, roli i pilotëve mbetet integral dhe i pazëvendësueshëm, duke siguruar sigurinë,

**“ DRONI DHE LAZERI
GODASIN PA EMOCION,
PA KEQARDHJE, PA FRIKË,
NUK LODHEN, NUK KANË
NEVOJA PERSONALE DHE
SHËNDETËSORE DHE
MUND TË QËNDROJË MBI
24 ORË NË AJËR. DRONËT
JANË TË PAJISUR ME
NJË SËRË SENSORËSH,
DUKE PËRFSHIRË GPS,
AKSELEROMETRA,
XHIROSKOPË DHE
MAGNETOMETRA, DUKE
U MUNDËSUAR ATYRE
TË KENË POZICIONIM TË
SAKTË DHE STABILITET
GJATË FLUTURIMIT.**



efikasitetin dhe preken njerëzore në qiell. Ndërsa teknologjia vazhdon të përparojë, e ardhmja e aviacionit ka të ngjarë të përfshijë një bashkëjetesë harmonike mes dronëve dhe pilotëve. Këtu janë disa aspekte për t'u marrë parasysh:

Dronët mund të plotësojnë operacionet me pilot duke marrë përsipër detyra të përsëritura ose me rrezik të lartë, duke i lejuar pilotët të fokusohen në vendimmarrje kritike dhe operacione komplekse. Pilotët mund të luajnë një rol kyç në analizimin dhe interpretimin e sasisë së madhe të të dhënave të mbledhura nga dronët, duke përdorur njohuritë dhe gjykimin e tyre për të nxjerrë njohuri të vlefshme dhe për të marrë vendime të informuara.

Me rritjen e dronëve, pilotët mund t'i nënshtrohen trajnimit dhe certifikimit të specializuar specifik për operimin dhe mbikëqyrjen e operacioneve të dronëve, duke siguruar që ata të kenë aftësitë e nevojshme për t'u përshtatur me nevojat në zhvillim të aviacionit. Industria e aviacionit do të vazhdojë të zhvillojë rregullore dhe standarde sigurie për të mundësuar integrimin e sigurt të dronëve në hapësirën ajrore, duke siguruar që pilotët dhe dronët të mund të operojnë në një mënyrë të koordinuar dhe reciprokisht të dobishme. Në fund të fundit,

bashkëjetesa e dronëve dhe pilotëve në të ardhmen do të përfshijë një ndryshim në role dhe përgjegjësi, duke krijuar mundësi të reja për pilotët njerëzorë që të përdorin ekspertizën e tyre së bashku me teknologjinë e dronëve.

Ndërsa industria e aviacionit vazhdon të përqafojë potencialin e dronëve, rolet dhe mundësitë për pilotët pritet të ndryshojnë dhe evoluojnë. Pilotët mund të specializohen në operacionet me dron, duke u bërë ekspertë në fluturimin, mirëmbajtjen dhe mbikëqyrjen e funksionimit të dronëve në industri të ndryshme si zbulimi ushtarak, fotografia ajrore deri tek kinematografia ose shërbimet e shpërndarjes së postës. Me rritjen e sasisë së të dhënave të mbledhura nga dronët, pilotët me aftësi analitike bëhen të paçmueshëm për analizimin dhe interpretimin e këtyre të dhënave për të nxjerrë njohuri domethënëse në fusha të tilla si inteligjenca, mbrojtja, bujqësia, inspektimi i infrastrukturës ose monitorimi i mjedisit.

Pilotët mund të ndajnë njohuritë dhe ekspertizën e tyre duke u bërë konsulentë ose instruktorë, duke trajnuar operatorët e rinj të dronëve, duke ofruar udhëzime për pajtueshmërinë me rregullat dhe duke ndihmuar bizneset të maksimizojnë potencialin e dronëve. Pilotët luajnë një rol vendimtar në situatat e reagimit emergjent, duke përdorur dronë për të vlerësuar zonat e pushtuara nga armiku, rajoni i fatkeqësive, për të ofruar furnizime mjekësore ose për të ndihmuar në misionet e kërkimit dhe shpëtimit, duke punuar në bashkëpunim me ekipet tokësore. Ndërsa industria e dronëve rritet, do të ketë një nevojë në rritje për pilotë me një kuptim të rregulloreve dhe standardeve të

sigurisë. Pilotët mund të kontribuojnë në formësimin dhe zbatimin e këtyre rregulloreve, duke siguruar operacione të sigurta dhe të përgjegjshme me dron. Këto janë vetëm disa shembuj të roleve dhe mundësive në zhvillim që presin pilotët në të ardhmen, ku integrimi i dronëve hap mundësi të reja emocionuese për karrierën e tyre.

Si përfundim, ndikimi i dronëve në industrinë e aviacionit paraqet sfida, por dhe mundësi. Krimi kibernetik mbetet një rrezik i qartë dhe i paraqitur për sektorin e aviacionit dhe të dronëve, i cili nuk mund të injorohet. Sektori po vë re lëvizje të një vale në rritje të sulmeve kibernetike, një rritje të niveleve të rrezikut, pasi shtetet, kriminelët, hakerat dhe sulmuesit kibernetikë të përpigjen të dobësojnë këtë shpikje të re sidomos në fushën ushtarake me shpikjen e armëve anti-dron, si para 100 vitesh me shpikjen e artilerisë kundërajrore. Duke lexuar me kujdes perspektivën e dronëve në luftën e Ukrainës dhe Izraelit në Gaza, ka akoma vend për diskutim të supremacisë së dronit apo pilotit, apo më mirë e bashkëpunimit a e të dyjave fenomeneve bashkë. Sidoqoftë, është e rëndësishme të mbajmë mend se dronët në fund të fundit kontrollohen dhe operohen nga njerëzit.

Përshatja: MIMOZA GOLIKJA

Dymbëdhjetë aleatë të NATO-s, Belgjika, Çekia, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Rumania, Spanja, Turqia dhe Mbretëria e Bashkuar, ranë dakord, më 25 mars 2029, të zgjerojnë më tej trajnimin e aviacionit ushtarak në të gjithë Aleancën, përmes nismës së NATO-s për Trajnimin e Fluturimit në Evropë (NFTE). Kjo përfshin vendosjen e parë ndonjëherë të rreth pesëdhjetë pilotëve studentë në katër lokacione, duke filluar këtë vit, shtimin e nëntë kampuseve të reja të trajnimit, si dhe krijimin e një organi këshillues të dedikuar për industrinë. NFTE synon të ndryshojë rrënjësisht mënyrën se si aleatët trajnojnë gamën e plotë të ekuipazheve ajrore, duke përfshirë pilotët për avionë, helikopterë dhe sisteme ajrore të pilotuara nga distanca.

NFTE, jo vetëm që po forcon aftësitë e forcave ajrore aleate, por gjithashtu po promovon unitetin aleat. Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm Mircea Geoană tha se "Uniteti nuk ndodh thjesht, por duhet fituar. Një mënyrë për ta arritur këtë është duke u trajnuar sistematikisht së bashku dhe duke krijuar marrëdhënie besimi në proces. 'NATO Flight Training Europe' është një shembull i shkëlqyer për këtë. Kjo përpjekje e rëndësishme shumëkombëshe do të na ndihmojë të shkatërrojmë kaponet kombëtare drejt një qasjeje të përbashkët për trajnimin e gjeneratave të ardhshme të ekuipazheve ajrore."

Me zgjerimin e fundit të numrit të kampuseve të trajnimit në katërbëdhjetë vende, NFTE tani po lehtëson trajnimin në shtatë vende aleate. Rritja e shpejtë e NFTE-së ka tërhequr interes rreth Aleancës me disa aleatë që priten të bashkohen në gjysmën e parë të 2024. Vendosija e grupit të parë të studentëve do të thotë që ekuipazhet ajrore aleate do të kenë akses në mundësitë e fundit të trajnimit.

Për shumë aleatë evropianë, kërkesat kombëtare të pilotëve që nevojiten çdo vit janë shumë të vogla për të justifikuar krijimin ose mirëmbajtjen e qendrave kombëtare të fluturimit. Për të kapërcyer këtë sfidë, iniciativa NFTE synon të krijojë një rrjet lehtësirash trajnimi shumëkombëshe për pilotët e avionëve luftarakë, helikopterëve, krahëve fikse dhe dronëve në të gjithë Evropën, duke shfrytëzuar strukturat tashmë ekzistuese në masën maksimale të mundshme. Krijimi i NFTE-së do të ulë ndjeshëm varësinë aktuale në objektet e trajnimit të SHBA-së, duke i bërë aleatët evropianë të aftë të trajnojnë ekuipazhet e tyre të fluturimit në një kontekst shumëkombëshe. Si i tillë, NFTE shërben si një shembull i shkëlqyer i ndarjes së barrës transatlantike.

NFTE u lançua në margjinat e Samitit të NATO-s 2021, në Bruksel. Aktualisht marrin pjesë 12 aleatë, Belgjika, Çekia, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Rumania, Spanja, Turqia dhe Mbretëria e Bashkuar. Pesë kampuse trajnimi NFTE janë krijuar në të gjithë Aleancën.

Arsimi dhe trajnimi, kohezion, efektivitet dhe gatishmëri

Të gjitha forcat aleate kanë nevojë për trajnim të mirë për t'u përballur me një sërë sfidash sigurie dhe për të kryer detyrat e tyre. Trajnimi shumëkombëshe u mundëson forcave të aleatëve të ndryshëm të stërviten së bashku, të përmirësojnë koordinimin dhe bashkëpunimin dhe të rrisin gatishmërinë e tyre. Për të ruajtur lirinë dhe sigurinë e anëtarëve të saj, Aleanca duhet të ruajë aftësitë për të parandaluar, zbuluar, penguar dhe mbrojtur kundër çdo kërcënimi agresioni. Për këtë arsye, NATO zhvillon programe edukimi dhe trajnimi për të rritur kohezionin, efektivitetin dhe gatishmërinë e forcave të saj shumëkombëshe. Për më tepër, NATO ndan ekspertizën e saj me vendet partnere në përpjekjet e tyre për reformën e arsimit dhe trajnimin. Që nga fillimi i saj në 1949, NATO është angazhuar në aktivitete arsimore dhe trajnimi, të cilat janë zgjeruar gjeografikisht dhe institucionalisht me kalimin e kohës.

Krijimi i Komandës Aleate të Transformimit (ACT), në vitin 2002, është dëshmi e vendosmërisë së NATO-s për të rritur arsimin dhe trajnimin. ACT është tërësisht i përkushtuar për të udhëhequr transformimin e strukturës, forcave, aftësive dhe doktrinës ushtarake të NATO-s, duke përfshirë projektimin dhe menaxhimin e stërvitjeve dhe trajnimeve. Ajo ka një qasje gjithëpërfshirëse për edukimin dhe trajnimin, siguron unitet përpjekjesh dhe ndihmon në identifikimin e boshllëqeve dhe shmangjen e dyfishimit, ndërkohë që siguron efektivitet dhe efikasitet më të madh përmes programimit global. Këto përpjekje janë plotësuese me programet kombëtare.

Komandanti Suprem i Aleatëve në Evropë (SACEUR), në krye të Komandës Aleate të Operacioneve (ACO), ofron udhëzime në nivel strategjik dhe përcakton prioritetet dhe kërkesat për Arsimin, Trajnimin, Ushtrimet dhe Vlerësimin e NATO-s (ETEE). Ndërkohë programet e edukimit dhe trajnimit të NATO-s ndihmojnë në përmirësimin e "ndërveprimin" të forcave shumëkombëshe, pra aftësinë e tyre për të punuar së bashku. Aleanca është gjithashtu e përkushtuar për bashkëpunim dhe koordinim efektiv me vendet

Marrëdhënie besimi në proces: Aleatët e NATO-s forcojnë bashkëpunimin në trajnimin e aviacionit ushtarak



partnere dhe organizatat ndërkombëtare, si Kombet e Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Bashkimi Afrikan.

Bashkëpunimi shumëkombëshe i aftësive

Ndërkohë, për të kryer misionet dhe detyrat e saj, NATO ka nevojë që aleatët të investojnë në pajisje të ndërveprueshme, moderne dhe me kosto efektive. Për këtë qëllim, NATO luan një rol të rëndësishëm për të ndihmuar vendet të vendosin se si dhe ku të investojnë në mbrojtjen e tyre. Aleanca gjithashtu mbështet aleatët në identifikimin dhe zhvillimin e projekteve bashkëpunuese shumëkombëshe për të ofruar aftësitë kryesore të mbrojtjes të nevojshme për sigurinë e Aleancës.

NATO po ndihmon aleatët dhe vendet partnere të identifikojnë mundësitë për bashkëpunimin e aftësive shumëkombëshe dhe të zhvillojnë Projekte me Vizibilitet të Lartë (HVP) në fusha kyçe, si furnizimi me karburant ajër-ajër, municionet, sistemet detare pa pilot, komanda dhe kontrolli dhe trajnimi. Qëllimi është të zvogëlohen kostot përmes ekonomive të shkallës, ndërkohë që përmirësohen vlerat operacionale përmes rritjes së përbashkët të pajisjeve, trajnimit, doktrinës dhe procedurave. NATO punon me Bashkimin Evropian për të shmangur dyfishimin dhe për të siguruar komplementaritetin e përpjekjeve. Aktualisht janë duke u zhvilluar 21 projekte që do të ofrojnë efikasitet të përmirësuar operacional, ekonomi të shkallës dhe lidhje midis aleatëve dhe partnerëve të NATO-s. Projektet aktuale janë:

Komandimi dhe kontrolli: Komanda e Komponentit të Operacioneve Speciale të Përbëra (C-SOCC), Komanda Rajonale e Komponentit të Operacioneve Speciale (R-SOCC), Aftësia komanduese dhe e kontrollit për mbrojtjen ajrore dhe raketore me bazë sipërfaqësore për nivelin e batalionit dhe brigadës (shtresa SBAMD C2), Strukturat e trajnimit.

Programi Shumëkombëshe i Aviacionit Special (MSAP): NATO-s Flight Training Europe (NFTE), Blerje e nivelit të lartë.

Aftësia e transportit të cisternës me shumë role (MRTT-C): Avion me shumë misione detare (M3A).

Sistemet Detare pa pilot (MUS): Rotorcraft i gjeneratës së ardhshme (NGRC), Zgjidhje modulare për aftësitë e mbrojtjes ajrore me bazë tokësore (Modular GBAD), Raketa kundërraketë, artileri dhe mortaja që mund të vendosen shpejt (C-RAM).

Lëvizshmëria ushtarake dhe Kundër-lëvizshmëria: Kalimi i hendekut, Kundër-lëvizshmëria, Automjete dhe sisteme inxhinierike ushtarake.

Municione: Municionet vendimtare të betejës ajrore (ABDM), Municionet vendimtare të betejës tokësore (LBDM), Municionet vendimtare të betejës detare (MBDM), Iniciativa Shumëkombëshe për Deponimin e Municioneve (MAWI), Mbrojtja kimike,

biologjike, radiologjike dhe bërthamore (CBRN).

Rrjeti i objekteve të mbrojtjes CBRN (CBRN-DF): Pajisjet e mbrojtjes CBRN (CBRN-PE), Zbulimi dhe identifikimi CBRN (CBRN-D&I).

Përveç kësaj, vendet vazhdojnë të diskutojnë fushat premtuese për bashkëpunim shumëkombëshe në mënyrë që të ofrojnë siguri me kosto efektive.

Si funksionon bashkëpunimi?

Aleatët po eksplorojnë vazhdimisht iniciativën të reja shumëkombëshe për të zhvilluar, në mënyrën më ekonomike, aftësitë kryesore që i duhen Aleancës për të përballuar sfidat e sotme të sigurisë. Në të njëjtën mënyrë si Nisma e Mbrojtjes së Zgjuar, e nisur nga Sekretari i Përgjithshëm i atëherëshëm i NATO-s Anders Fogh Rasmussen në vitin 2012, bashkëpunimi shumëkombëshe i aftësive po ndihmon gjithashtu Aleancën të zhvillojë, të fitojë dhe të mbajë aftësitë në një mënyrë me kosto efektive dhe efikase.

Projektet e dukshmërisë së lartë (HVP) të NATO-s fokusohen në ofrimin e aftësive më kritike në një mënyrë të përshtetshme, duke krijuar angazhime politike në formën e marrëveshjeve të nënshkruara nga Ministrat e Mbrojtjes. Një dokument fillestar, i quajtur gjithashtu Letra e Qëllimit (LOI), që përshkruan idenë e përgjithshme të bashkëpunimit, nënshkruhet nga Ministrat e Mbrojtjes të përfshirë në projekt. Ai pasohet nga nënshkrimi i një Memorandumi Mirëkuptimi (MOU), një dokument ligjor i detyrueshëm që specifikon detajet e bashkëpunimit. Memorandumet e mirëkuptimit ofrojnë kuadrin ligjor të nevojshëm për ekzekutimin e fazës së zbatimit drejt ofrimit të aftësisë specifike. Përfshirja e nivelit të lartë politik rrit në mënyrë dramatike perspektivat e përparimit të përshatshëm dhe të prekshëm.

Në fazën e zbatimit të shumicës së projekteve, Agjencia e NATO-s për Mbështetjen dhe Prokurimin (NSPA) është ndërmjetëse ndërmjet vendeve dhe industrisë. Kjo mund të ndodhë në nivele të ndryshme: NSPA mund të ftojë industrinë të prezantojë zgjidhje për aleatët dhe partnerët për t'i blerë, të përfshihen në procesin e prokurimit, apo edhe të negociojnë në emër të vendeve me industri.

Konferenca e Drejtorëve Kombëtarë të Armatimeve (CNAD) komiteti i lartë i NATO-s që mbledh së bashku zyrtarët më të lartë kombëtarë përgjegjës për prokurimin e mbrojtjes në vendet anëtare dhe partnere të NATO-s – është gjithashtu i përfshirë në bashkëpunimin e aftësive shumëkombëshe. Ajo ka për detyrë identifikimin e mundësive të bashkëpunimit për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e pajisjeve ushtarake dhe sistemeve të armëve dhe është përgjegjëse për një numër projektesh armatimesh bashkëpunuese, që synojnë të pajisin forcat e NATO-s me aftësi të avancuara.

"Nënëloket shqiptare janë mitra e kombit, ku u ngjiz e brumos breznia dhe identiteti"

Mine Peza ka lindur në vitin 1885, në katundin Ndroq, në familjen patriotike të Alhysëve, familje e varfër por me shpirt atdhetar. Të parët e saj kanë urryer regjimin shtypës të Turqisë, po ashtu edhe regjimin e Zogut. Në Luftën e Parë Botërore i vetmi vëlla që pati, ka rënë dëshmor, duke luftuar kundër pushtuesve serbë. Minia në rininë e saj u rrit dhe edukua me dashurinë për atdheun dhe urrejtjen për shtypësit e shfrytëzuesit, të cilët me reprezaljet që përdoreshin kundër katundarëve për t'i marrë taksat, duke i lënë pa bukë në vatër, rritën në shpirtin e Mines, urrejtjen për këta shtypës e shfrytëzues.

Minia u martua me Miftar Bilalin nga Peza e Vogël dhe ky me prejardhje familje patriotike që punonte për bukën e gojës. Së bashku me Minen, lindën dhe rritën tre fëmijë, dy vajza dhe një djalë. Minia ishte një grua punëtore, mjaft mikpritëse, bujare, e dashur dhe gojëmbël me bashkëfshatarët dhe me miqtë e shokët e shkathët e pa përtuar, ishte shumë e gjindshme për të përkrahur të tjerët në fatkeqësi dhe në gëzime. Të gjithë katundarët e Pezës së Vogël e donin dhe e respektonin si bijën e tyre.

Populli ynë që, më 7 prill 1939, i priti okupatorët fashistë Italian me demonstrata dhe me pushkë, duke i treguar se populli nuk e donte pushtimin fashist dhe kërkoi që t'i shporrte nga Shqipëria dhe të linte të lirë popullin. Dëshirës së popullit për ta lënë të lirë, fashistët dhe përkrahësit e tyre, tradhtarët e Kombit si Shefqet Bej Vërlaci, u vunë në shërbim të okupatorit kundër popullit. Demonstratën antifashiste të popullit të Tiranës, më 28 nëntor 1939, të organizuar nga komunistët, nxënësit e shkollave dhe nga gratë antifashiste me parullat: "Rroftë Shqipëria! Rroftë Flamuri Kombëtar!", qeveria fashiste shqiptare u mundua që ta shfrytëzonte, pra festën e ditës së Flamurit për interesat e saj, prandaj nuk përdori arrestime, por vetë parullat që u hodhën treguan urrejtjen e popullit.

Demonstrata e 28 tetorit 1941, kundër festimit të përvjetorit të marshimit të fashistëve mbi Romë

Kishin kaluar dy vjet nga okupacioni fashist ku, më 28 tetor 1941, në Tiranë me iniciativën e komunistëve të grupeve shpërtheu demonstrata e parë antifashiste, ku protagonistë kryesorë ishin komunistët, rinia e shkollave të mesme, gratë antifashiste dhe populli patriot i Tiranës. Në këtë tubim kur Tefik Mborja, i cili ishte Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Fashiste Shqiptare, mori fjalën e rastit, u ndërpre nga studentët pjesëmarrës, të cilët hodhën parullat: "Rroftë Shqipëria e lirë! "Poshtë fashizmi!". Studentët lanë sallën në mënyrë demonstrative, duke kënduar këngët patriotike: "Për Mëmëdhenë", "Eja mblidhuni këtu, këtu" dhe me flamurin kombëtar në krye filluan manifestimin në rrugët kryesore të Tiranës, ku iu bashkuan qindra qytetarë të Tiranës.

Demonstruesit në rrugët kryesore u përballën me forca të mëdha të karabinierisë e të milicisë fashiste. Gjatë përleshjes pati të plagosur nga të dy palët. Disa demonstrues u arrestuan. Kjo demonstratë pati jehonë të madhe në tërë vendin, i dha një goditje të rëndë pushtuesve fashistë e shërbëtorëve të tyre.

Mine Peza, për arsye se nuk po përballonte jetën në fshat, erdhi në Tiranë. Shtëpinë ku banonte e ktheu në një bazë të sigurt për ilegalët dhe për fshehjen e antifashistëve dhe komunistëve, ajo ka pritur e kuruar të plagosur, për këtë aktivitet është kontrolluar disa herë nga spiunët fashistë, por me zgjuarsë e shkathhtësi ia ka hedhur fashistëve, këtu vinin shumë edhe nga fshati. Minia, i shoqi Miftari, vajza Shaje, djali Qazim Bilali, vajza Ferideja, të gjithë u përfshinë në luftën ANÇ deri në fund. Djali i Mines që në fillim shkoi partizan në Çetën e Babë Myslimit dhe, më 5 nëntor 1943, ra heroikisht në luftë me nazistët gjermanë në betejën e Qaf Kallmit. I shoqi i Mines dhe dy vajzat vazhduan luftën antifashiste deri në Çlirimin e plotë të Shqipërisë. Duke marrë dekoratat e Trimërisë, Kujtimit dhe të Çlirimit, ka marrë edhe Statusin e Veteranit të LANÇ-it.

Mine Peza në Tiranë u njoh me komunisten Meriban Najdeni, Nexhmije Xhunglinin etj., dhe mori pjesë në të gjitha demonstratat antifashiste që u zhvilluan në Tiranë.

Demonstrata antifashiste e grave të Tiranës, më 17 shtator 1942

Pushtuesit fashistë, me synim për t'i dhënë goditje lëvizjes ANÇ, që kishte marrë shtrirje të gjerë në tërë vendin në mënyrë shumë sekrete, përgatitën plane për internimin në ishujt e Italisë, të dhjetëra të rinjve e të rejave, të burgosur politikë.

Qarkori i PKS-së së Tiranës, e vlerësoi këtë moment dhe mori masa të shpejta. U thirr një mbledhje e shpejtë e celulës të shoqeve komuniste në shtëpinë e Meriban Najdenit. Këtu u shtrua detyra që t'u bëhej thirrje grave e vajzave të qytetit të



demonstronin përpara burgut në pasditen e 17 shtatorit, ora 16.00. Dhjetëra gra e vajza të udhëhequra nga shoqet komuniste të veshura me çarçaf, nën pretekstin e takimit me njerëzit e tyre të burgosur, iu afruan ndërtesës së burgut, që ruhej nga forca të shumta policore dhe kërkuan të takoheshin me djemtë e vëllezërit e tyre. Ata i kërkuan demonstruesve që të hiqnin perçet, por ato refuzuan dhe menjëherë ndërhyrën forcat e policisë, duke i shtyrë e goditur me qytat e pushkëve. Demonstruesit i bën ballë sulmit të policisë dhe ishin të vendosur të mos zbrapseshin. Nga gjokset e tyre buçitën thirrjet: "Poshtë fashizmi", "Mos na i internoni djemtë dhe vëllezërit tanë në Itali". "Na lironi djemtë". Me këto thirrje të grave u bashkua dhe zëri i fuqishëm i të burgosurve, të cilët nga dritaret e burgut hidhnin parulla si: "Poshtë fashizmi! Rroftë Shqipëria e lirë! Fashistë, mos vini dorë mbi nënat dhe motrat tona! Rroftë lufta Çlirimtare!". Me demonstruesit u bashkuan shumë gra e vajza të familjeve që banonin në afërsi të burgut.

Të befashuar nga një demonstratë e tillë si dhe nga vendosmëria e grave dhe vajzave të Tiranës, autoritetet e qeverisë fashiste, dërguan forca të shumta policore të komanduara nga vetë ish-prefekti i Tiranës, Qazim Mulleti, i cili dha urdhër të qëllohej mbi

demonstruesit dhe u arrestuan shumë gra, të cilat u përplasën në birucat e kuesturës. Ndërsa gruaja që u godit rëndë nga plumbat e fashistëve, ishte bija nga Peza Heroike, Mine Peza. Ajo u bë Dëshmorja e parë nga radhët e grave Antifashiste të Tiranës, e cila i la amanet shokëve dhe djalit të saj që ishte partizan, që të luftonin fashizmin deri në fund të Çlirimit të vendit.

Poeti popullor i ka dedikuar kësaj gruaje trimëshë, këto vargje në këngë:

Ku kam vajzën, ku kam djalin!

M'i kanë fut n'at burg të zi.

Far'e fisin ma kan tretur,

Larg në ishuj, n'Itali...

Kjo demonstratë pati jehonë të madhe në tërë vendin. Ajo tregoi për forcën e rolin e madh të gruas shqiptare në Luftën ANÇ që zhvilloi populli shqiptar për Çlirimin e vendit. Ndërsa kënga u përhap në të gjithë vendin si himn lufte.

Pas Çlirimit, Presidiumi i Kuvendit Popullor i ka akorduar titullin më të lartë Heroinë e Popullit. Një nga rrugët kryesore të Tiranës mban emrin Mine Peza. Para burgut të vjetër është ngritur një lapidar kushtuar aktit heroik që kreu Heroina e Popullit Mine Peza. Kënga e saj është incizuar dhe këndohet kudo.

TË JESH GRUA, NËNË: GARË VRAPIMI ME PENGESA

Grua, nënë, statuse që të lidhin me një aventurë të ndërlikuar dhe të mrekullueshme. Nën timerjetojnë çaste të vjera gëzimi, të cilat nuk do t'i këmbenin as me gjithë botën. Megjithëkëtë, ndonjëherë disa nëna ndihen sikur janë në prag të një krize nervore. Shpesh gratë e krahasojnë jetën e tyre si nëna, me një vrapim me pengesa. Dhe duket sikur, me kalimin e kohës, pengesat bëhen më të shumta e më të larta.

Nën timer mund të sakrifkohen kohën e lirë dhe një pjesë të mirë të jetës shoqërore për t'u dhënë kujdesin e duhur fëmijëve të tyre. "Jam gjithnjë në gatishtëmëri. I kam këmbyer banjat çlodhëse me një dush të shpejtë dhe darkat romantike me ushqimin që ngrohet me mikrovalë. Më kanë mbetur udhëtime që s'i kam bërë, vende që s'i kam parë, gjëra që s'i kam bërë. Por rrobat i kam të lara dhe të palosura"...

Sigurisht, shumë nëna do të flisin edhe për çastet e pakrahueshme të gëzimit që provojnë ndërsa rritin fëmijët: "Një buzëqeshje e rastësishme, një 'faleminderit mami' e ëmbël dhe përqaftimet e ngrohta, këto janë karburanti që të shtynë të vazhdosh përpara".

Nën timer punojnë jashtë shtëpisë

Një pengesë e madhe, e cila e ka ndërlikuar jetën e nënave, është se shumë prej tyre përballojnë përgjegjësitë e zakonshme familjare ndërkohë që për të mbështetur financiarisht familjen fillojnë një punë jashtë shtëpisë. Shumë nga këto nëna nuk kanë zgjedhur vetë të punojnë jashtë shtëpisë, por i shtyn nevojat. E dinë se po të rrinë në shtëpi, familjeve, e sidomos fëmijëve të tyre, do t'u mungojnë shumë gjëra. Pagat e tyre, edhe pse shpesh më të ulëta se ato të burrave që bëjnë një punë të ngjashme, kanë shumë rëndësi.

Për shembull, në San-Paulo të Brazilit, gratë përbëjnë 42 për qind të fuqisë punëtore. Njëra nga gazetaret në atë vend, i quante nënat që gjatë gjithë kohës merren vetëm me rritjen e fëmijëve një "lloj që rrezikon të zhduket". Në zonat fshatare të Afrikës është diçka e zakonshme të shohësh një nënë me një deng me dru mbi kokë dhe me fëmijën e lidhur me pëlhurë në shpinën e saj.

Gruaja - nënë

Duke i shtuar pengesat, tregu i punës mund të kërkojë që nënat të kalojnë shumë orë në punë. E kërkesat mund të mos ndalen aty. Shpesh punëdhënësit mund t'u bëjnë presion nënave që të kthehen në punë sa më shpejt të jetë e mundur pas lindjes së fëmijës. Zakonisht, edhe pasi rikthehen, nuk u bëhet asnjë ulje në orët e punës. Pra, nuk bëhet asnjë rregullim për to, duke pasur parasysh faktin që tani kanë përgjegjësi ndaj një fëmije shumë të vogël. Nuk kanë mundësi të marrin leje të zgjatur, pasi do të kenë vështirësi financiare. Nën timer mund t'u duhet të përballojnë edhe mangësitë që kanë institucionet ku lënë fëmijët, si edhe asistencën e pamjaftueshme nga shteti. Nga ana tjetër, ka disa nëna që nuk punojnë për nevojat financiare, por që të ndiejnë se kanë arritur diçka në jetë.

Gratë si zhonglere

Nuk është e lehtë të baraspeshosh punën me familjen. Një nënë duke pasqyruar ndjenjat e shumë nënave, tha: "E lodhur, e lodhur, e lodhur. Madje, zgjojohem e lodhur. Kur kthehem nga puna, jam e dërrmuar nga lodhja. Fëmijët kanë filluar të thonë 'mami është gjithmonë e lodhur' dhe kjo më bën të ndihem fajtorë. Nuk dua ta humbas punën, por edhe dua të jem ajo nëna e shoqërueshme dhe që e bën gjithçka të mundur. Mirëpo nuk jam pasqyrimi i përsosmërisë, siç dua të jem".

Ajo është një nga miliona nënat që punojnë, të cilat përqaftuan idenë se mungesat e shpeshta mund të kompensohen pjesërisht me 'kohën cilësore' që kalojnë me fëmijët. Por u vu re se kjo ide nuk është e suksesshme. Sot shumë nëna thonë se në përpjekjet për të mbajtur si një zhonglere stresin e punës dhe përgjegjësitë familjare, ato mbeten të mbingarkuara me punë, tej mase të tendosura dhe jo të paguara sa duhet.

Kur gratë kalojnë shumë kohë larg fëmijëve të tyre, këta të fundit nuk marrin gjërat për të cilat kanë më shumë nevojë: kohën dhe vëmendjen e nënës. Nga ana tjetër, nënat që rrinë gjithë kohën në shtëpi për t'u kujdesur për fëmijët e tyre thonë se u duhet të durojnë përcmimin dhe përbuzjen e një shoqërie të prirur për të lartësuar punën që paguhet. Në disa shoqëri, të jesh grua shtëpiake nuk shihet më si një pozitë e nderuar, kështu që gratë ndihen nën timer për të pasur punën e tyre, edhe sikur të ardhurat shtesë të mos jenë të nevojshme.

Lihen të luftojnë vetëm

Pengesave të nënave u shtohet edhe ky fakt: e lodhur tërë ditën në punë, një nënë vjen në shtëpi, jo që të pushojë, por që të vazhdojë



me punët e përditshme të shtëpisë. Nën timer, bëjnë ose jo një punë jashtë shtëpisë, shpesh shihen si të vetmet që janë përgjegjëse për t'u kujdesur për shtëpinë dhe fëmijët.

Ndërkohë që gjithnjë e më shumë nëna po punojnë me orare të zgjatura, baballarët nuk i ndihmojnë gjithmonë. Disa burra ankohen se gratë e tyre e kanë të vështirë t'i lënë të tjerët që të bëjnë punët, sepse këmbëngulin që çdo gjë të bëhet ashtu siç e bëjnë ato zakonisht. "Përndryshe, ti e bën keq", thonë burrat. Është e qartë se një amvisë të lodhur mund t'i duhet të bëjë ca lëshime për sa i përket mënyrës se si bëhen disa punë shtëpie, me qëllim që të përfitojë nga bashkëpunimi i të shoqit. Nga ana tjetër, burri nuk duhet ta përdorë këtë argument si një justifikim për të mos bërë asgjë.

Shtohen pengesat

Edhe zakonet e rrënjosura thellë mund t'i shtojnë pengesat. Në Japoni nga nënat pritet që të rritin fëmijët në mënyrë të ngjashme me bashkëmohatarët e tyre. Nëse fëmijët e tjerë po marrin mësim për piano a për pikturë, një nënë ndihet e detyruar që edhe fëmijët e saj të bëjnë të njëjtën gjë. Shkollat ushtrojnë presion te prindërit që fëmijët të marrin pjesë në veprimtaritë jashtëshkollore si edhe fëmijët e tjerë. Nëse je ndryshe mund të ndodhë që fëmijët, mësuesit, prindërit e tjerë dhe të afërmit të të ngacmojnë. E njëjta gjë është e vërtetë edhe në vende të tjera.

Reklamat dhe nxitja për të blerë mund t'i shtojnë fëmijët që të kërkojnë më shumë gjëra. Në vendet e zhvilluara nënat mund të mendojnë se duhet t'u sigurojnë fëmijëve atë që dëshirojnë, sepse shohin nënat e tjera që ua sigurojnë këto gjëra fëmijëve të tyre. Nëse nuk mundin, mund të ndihen sikur kanë dështuar.

Ky diskutim për nënat, në ditët tona nuk duhet të errësojë punën e miliona nënave të palodhura e vetëmohuese, të cilat bëjnë më të

mirën e tyre për të përmbushur një nga përpjekjet më fisnike, atë të rritjes së brezave të ardhshëm të familjes njerëzore. Ky është një privilegj.

Anketë

Në Hong-Kong, 60% e nënave që punojnë nuk u kushtojnë fëmijëve atë që ato e quajnë kohë e mjaftueshme për ta. Dhe, gjatë ditëve të punës së prindërve, 20% e fëmijëve deri në moshën trevjeçare jetojnë larg shtëpisë, zakonisht me gjyshërit.

Gratë në Meksikë kalojnë afro 13 vjet të jetës, duke u kujdesur për të paktën një fëmijë nën 5 vjeç.

Në Irlandë 60% e grave qëndrojnë në shtëpi që të kujdesin për fëmijët e tyre. Afro 40% e grave në Greqi, Itali dhe Spanjë bëjnë të njëjtën gjë.

Ndihma në shtëpi

Në Japoni, 80% e grave shtëpiake thanë se dëshironin që një pjesëtar i familjes t'i ndihmonte për punët e shtëpisë, sidomos kur janë të sëmurë.

Në Holandë burrat kalojnë rreth 2 orë në ditë me fëmijët dhe 42 minuta duke bërë punët e shtëpisë. Gratë kalojnë rreth 3 orë me fëmijët dhe 1 orë e 42 minuta duke bërë punët e shtëpisë.

Në Gjermani më shumë se 70% e nënave ndihen të stresuara. Afro 51% ankohen për dhembje që kanë të bëjnë me shtyllën kurrizore dhe disqet ndër-rruazore. Më shumë se një e treta janë vazhdimisht të lodhura dhe të shkurajura. Pothuajse 30% vuajnë nga dhembja e kokës ose nga migrena.

Në Hong-Kong, 4% e grave të anketuara thanë se i kishin keqtrajtuar gjatë shtatzënisë.

Ndërsa në Gjermani pothuajse 1 në 6 nëna pranoi se të paktën një herë fëmija i saj e ka sulmuar fizikisht.



Tragjedia e Otrantos ndodhi më 28 mars 1997, njohur ndryshe edhe si Përmytja e Katerit të Radës

Anija shqiptare me 142 persona në bord, u përmyt nga forcat detare italiane në Ngushticën e Otrantos, duke shkaktuar humbjen e jetës së 57 personave, të moshave nga 3 deri në 69 vjeç. Emigrantët ishin bërë pjesë e emigrimit të madh nga Shqipëria për shkak të kryengritjes, e cila filloi pas kolapsit të skemave të piramidave. Në mënyrë për të shmangur hyrjen ilegale të emigrantëve, forcat detare italiane proceduan në mënyrë të menjëhershme për të bllokuar hyrjen ilegale në brigjet e Italisë.

Gjatë procedurës së ndalimit, anija italiane "Sibilla" u përplas me katerin e radës, duke e mbytur atë e duke rezultuar në vdekjen e 57 personave në bord.

Kapitenët e anijes italiane ishin përgjegjës të përmytjes. Ngjarja ngriti shumë polemika mbi shtrirjen e fuqisë që një vend mund të ekzekutojë për të mbrojtur veten nga një hyrje e paautorizuar. Argumentet e paraqitura tregonin se një vend duhet të limitojë misionet shtrënguese, të cilat janë tepruara për ndalimin e hyrjes ilegale. Komisioneri i Kombeve të Bashkuara kritikoi bllokazhin derisa të krijohej një vendim i përbashkët ndërqeverisës midis Shqipërisë dhe Italisë.

Pas viteve të izolimit të detyruar dhe ndalimit për të udhëtuar lirisht, mijëra shqiptarë emigruan në Itali dhe Greqi në fillim dhe gjatë viteve 90' kur sistemi komunist u përmyt.

Vala e parë e njerëzve, të cilët emigruan në Itali ishte në mars

64 kilometrave gjerësi me migrimin e viteve 90'. Në vitin 1997 kriza kishte pushtuar Shqipërinë për shkak të kolapsit të skemave piramidale, të cilat sollën mos orientim dhe dhunë civile në vend. Në imponim mbikëqyrjeje sollën në Itali frikën e një vale të madhe emigrantësh. Shteti italian kishte zbatuar nën një akordim bilateral për të mbartur anijet shqiptare sa herë që do të haseshin në det.

Duke filluar nga 3 marsi 1997, do të kthehej në Shqipëri çdo anije, duke u kompensuar me ndihma financiare nga Italia. Gjendja ushtarake ishte e stabilizuar në det midis dy vendeve, duke mos lejuar kalimin ilegal.

të radës, e cila pasoi me vdekje. Pas kësaj anija italiane iku duke u kthyer sërisht pas 20 minutash. Numri total i personave që humbën jetën mund të jetë 83. Të mbijetuarit u morën dhe u dërguan në portin e Brindisit, ku më pas u identifikuan në qendrat e emigracionit. Më 29 dhe 30 mars 1997, lajmi i fatkeqësisë ishte në faqet e para të gazetave italiane, duke e lidhur ngjarjen si konflikt apo përplasje.

31 marsi ishte ditë zie në Shqipëri. Më 28 mars, Këshilli për sigurinë i Kombeve të Bashkuara adaptoi rezolutën 1101, e cila ndërmori një mbrojtje ndërnacionale për mbrojtjen në Shqipëri, duke thjeshtësuar dërgimin e ndihmave humanitare. Forca u njoh si Operacioni "Alba", e cila u drejtua nga italianët, ku morën pjesë 6 500 ushtarë nga 8 vende të tjera. Arsyeja e pashprehur ishte burimi i valës së refugjatëve.

Aksidenti ngriti pyetjet mbi shtrirjen e fuqisë që një vend mund të përdorë nga hyrjet e paautorizuara. Megjithatë përmytja ishte e paqëllimshme, kontradikta ekziston mbi rezultatin e manovrës së rrezikshme, e cila ishte e papërshtatshme në lidhje me ndalimin e anijes. Autorët pranojnë se është detyrim ndalimi i veprimeve shtrënguese, të cilat sjellin një ndërhyrje të rrezikshme. Komisioneri i Lartë për refugjatët i Kombeve të Bashkuara kritikoi bllokazhin italian si jo legal, përdërisa Italia kishte ndërmarrë një marrëveshje me qeverinë shqiptare.

Xhavara deklaroi se rasti midis Italisë edhe Shqipërisë ishte i papranueshëm për shkak të mjeteve jo të zakonshme. Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila ndërmori juridiksionin, duke u mbështetur në marrëveshjen dypalëshe midis Shqipërisë dhe Italisë, deklaroi se anija ishte ende në territorin shqiptar, 24 kilometra nga bregu. Gjykata bëri Italinë fajtoreshë për incidentin, duke konsideruar ushtrimin e juridiksionit. Italia ishte përgjegjëse dhe ndërmori më pas investigimet mbi të vdekurit, një kërkesë e cila konsiderohej të jetë përmbushur nga procedurat publike të vrasjes kundër kapitenit të anijes italiane.

Në vitin e 8-të të procedurave, gjykata e Brindisit dënoi kapitenët italianë dhe shqiptarë së bashku me akuzën e "mbytjes së anijeve dhe vrasjen e shumëfishtë" nga 3 deri në 4 vjet, duke iu atribuar të dyve në nivel individual.

Tragjedia shumë shpejt u bë pjesë e këngëve popullore shqiptare, të cilat u dedikoheshin rapsoditë e emigrantëve shqiptarë para luftës së dytë botërore. Ato kishin metafora dhe performanca popullore me vajtime dedikuar tragjedisë së Otrantos. Pjesë të katerit të radës janë transportuar në hyrje të portit të Otrantos si monument për tragjedinë. Ky projekt u realizua nga skulptori grek Costas Varotsos. Më parë anija ishte lënë e braktisur në brigjet e Otrantos.



Përmendore në portin e Otrantos

dhe më pas në gusht të vitit 1991

Vala e parë u 'ngjall' nga fjala se Italia ishte duke dhënë viza, duke bërë kështu mijëra njerëz të mobilizoheshin nëpër anije të të gjitha madhësive në Portin e Durrësit.

Qeveria komuniste e cilësoi këtë valë si çmenduri kombëtare. Atëherë 20 000 shqiptarë kishin arritur Italinë, më së shumti në portin e Brindisit. Pjesa më e madhe e medias italiane e cilësoi këtë situatë si "barbarë" që pushtuan tokën Italiane. Si pasojë e Luftës së Gjirit në Irak, opinionistët italianë shprehën shqetësimin në lidhje me dyshimin e "rrezikut islamik nga emigrimi". Disa të tjerë e lidhën ngjarjen me invadimet osmane në Otranto (1480-1481) përgjatë

Përplasje

Anija italiane "Sibilla" kërkoi të ndalonte dhe të inspektonte anijen nëse kishte emigrantë të jashtëligjshëm, por përfundoi duke e përmytur atë. Sipas autoriteteve italiane nuk ishte asnjë qëllim për të shkaktuar këtë përmytje. Komandanti i anijes "Zefiro", fillimisht kishte vërejtur përfaqshën e një motoskafit dhe kishte identifikuar katerin e radës si një motoskaf me rreth 30 persona në bord. Motoskafi vazhdoi lundrimin drejt Italisë pavarësisht urdhrimit të "Zefiro-s" për t'u ndaluar. Kjo ndodhi rreth orës 16.30, pranë ishullit shqiptar të Sazanit. "Sibilla", atëherë bëri misionin e saj dhe përgjatë manovrës së saj, anija italiane shkaktoi kthimin e katerit

Mikroplastika mund të rrisë rrezikun e një ataku në zemër: Zbulohen fragmente të vogla në arteriet tona

Nga Hendeku "Mariana" 6,8 milje i thellë deri në majën e malit Everest, mikroplastikët janë gjetur pothuajse të gjithë në Tokë.

Tani, shkencëtarët kanë zbuluar grimcat e vogla plastike brenda arterieve tona të bllokuara. Studiuesit nga Universiteti i Campania-s gjetën copa të vogla plastike në më shumë se gjysmën e pacientëve që i nënshtroheshin procedurave për të pastruar një arterie të madhe në qafë.

Gjetjet kanë ngritur shqetësime se mikroplastika mund të rrisë rrezikun e sëmundjeve të zemrës, goditjeve në tru dhe vdekjes.

"Të dhënat tona do të ndikojnë në mënyrë dramatike në shëndetin kardiovaskular nëse konfirmohen, sepse ne jemi të pambrojtur ndaj ndotjes plastike", - tha Dr. Raffaele Marfella, autori i parë i studimit.



Në studim, shkencëtarët analizuan 304 pacientë, të cilët i ishin nënshtuar procedurave për të pastruar një arterie të madhe në qafë.

Më shumë se gjysma (58 për qind) u zbulua se kishin copa plastike mikroskopike dhe nanoskopike 'me tehe të dhëmbëzuara' në pllakën që rreshton enën e gjakut. Kjo përfshinte polietileni dhe klorur polivinil.

"Polietileni dhe kloruri polivinil, në format e tyre të ndryshme, përdoren në një gamë të gjerë aplikimesh, duke përfshirë prodhimin e kontejnerëve të ushqimit dhe kozmetikës dhe tubave të ujit", shkroi ekipi në studimin e tyre, të botuar në "New England Journal of Medicine".

Pacientët me grimca plastike në pllakën e tyre të arteries karotide kishin një rrezik 4.5 herë më të lartë për të përjetuar një atak në zemër ose goditje në tru ose për të vdekur gjatë tre viteve të ardhshme, zbuluan studiuesit pasi morën parasysh faktorët e tjerë të rrezikut të individëve.

Ata pacientë gjithashtu kishin nivele të larta të proteinave inflamatore në gjakun e tyre që dihet se luajnë një rol në arteriosklerozën dhe dështimin e zemrës, thanë studiuesit.




Studimet e mëparshme kanë zbuluar lloje të ndryshme të mikroplastikës dhe nanoplastikës në inde të shumta, duke përfshirë zorrën e trashë, mëlçinë, shpretkën, indet e nyjeve limfatike dhe placentën.

Ndërsa studimi i ri nuk mund të vërtetojë se plastika shkaktoi ngjarjet negative të pacientëve, është i pari që lidh grimcat e vogla me rezultatet e sëmundjeve kardiovaskulare të njerëzit, Dr. Philip Landrigan i Kolegjit të Bostonit, i cili nuk ishte i përfshirë në studim, shkroi në një editorial se shoqëroi raportin.

Gjetja e mikroplastikës dhe nanoplastikës në pllakë është 'një zbulim i madh', shkroi Dr. Landrigan.

Ndër pyetjet që ngre, tha ai, janë nëse ekspozimi duhet të konsiderohet një faktor rreziku kardiovaskular dhe si mund të



Studiuesit nga Universiteti i Campania-s gjetën copa të vogla plastike në më shumë se gjysmën e pacientëve që i nënshtroheshin procedurave për të pastruar një arterie të madhe në qafë.

reduktohet ekspozimi.

Në një raport të vitit 2022 mbi ekspozimin dietik dhe thithës ndaj copave të vogla të plastikës, Organizata Botërore e Shëndetësisë vuri në dukje se plastika nuk i përket mjedisit dhe se duhen marrë masa për të zbutur ekspozimin.

"Kostoja e ulët dhe komoditeti i plastikës janë mashtuese", - tha Landrigan.

"Në fakt, ato maskojnë dëme të mëdha, siç është kontributi i mundshëm i plastikës në rezultatet që lidhen me pllakën aterosklerotike".

Çfarë mund t'i bëjnë mikroplastikat trupit të njeriut nëse përfundojnë në përmbajtjet tona ushqimore?

Sipas një artikulli të botuar në Gazetën Ndërkombëtare të Kërkimeve Mjedisore dhe Shëndetit Publik, kuptimi ynë i efekteve të mundshme në shëndetin e njeriut nga ekspozimi ndaj mikroplastikës përbëjnë boshllëqe të mëdha njohurish.

Njerëzit mund të ekspozohen ndaj grimcave plastike nëpërmjet konsumimit të ushqimeve të detit dhe produkteve ushqimore tokësore, ujë të pijshëm dhe nëpërmjet ajrit.

Megjithatë, niveli i ekspozimit të njeriut, përqendrimet e efekteve toksike kronike dhe mekanizmat themelorë me të cilët mikroplastika

shkakton efekte, ende nuk janë kuptuar mirë sa duhet, për të bërë një vlerësim të plotë të rreziqeve për njerëzit.

Sipas Rachel Adams, një pedagoge e vjetër në Shkencën Biomjekësore në Universitetin Metropolitan të Cardiff-it, gëlltitja e mikroplastikës mund të shkaktojë një sërë efektesh potencialisht të dëmshme, si p.sh.

Inflamacioni: kur ndodh inflamacioni, qelizat e bardha të trupit dhe substancat që ato prodhojnë na mbrojnë nga infeksioni. Ky sistem imunitar normalisht mbrojtës mund të shkaktojë dëmtime në inde.

Një përgjigje imune ndaj çdo gjëje që njihet si 'e huaj' për trupin: përgjigjet imune si këto mund të shkaktojnë dëme në trup.

Duke u bërë bartës të toksinave të tjera që hyjnë në trup: mikroplastika në përgjithësi largon ujë dhe do të lidhet me toksinat që nuk treten, kështu që mikroplastika mund të lidhet me përbërës që përmbajnë metale toksike si merkuri dhe ndotës organikë si disa pesticide dhe kimikate të quajtura dioksina. të cilat dihet se shkaktojnë kancer, si dhe probleme riprodhuese dhe zhvillimore. Nëse këto mikroplastika hyjnë në trup, toksinat mund të grumbullohen në indet yndyrore.

Avionët ushtarakë më të përdorur në Tokë

“F-16 Fighting Falcon” është një nga avionët luftarakë më të përdorur në botë. Edhe pse u prezantua në shërbim në 1978, ai vazhdon të jetë një sistem armësh gjerësisht popullor. Për shumë ushtri, ai vepron si një opsion relativisht me kosto të ulët dhe me performancë të lartë, madje edhe në krahasim me avionët më të rinj luftarak. “Fighting Falcon” është vetëm një nga shumë avionë ushtarakë që përshkon shumë forca ajrore kombëtare.

Për të identifikuar avionët ushtarakë që përdoren më gjerësisht, iu referuam raportit të Forcave Ajrore Botërore 2023 nga “FlightGlobal”, një faqe interneti e industrisë së aviacionit dhe hapësirës ajrore.

Ashtu si “F-16”, shumë prej këtyre avionëve ushtarakë janë relativisht më të lirë se sa homologët e tyre më të rinj, duke i bërë ata më të përballueshëm për vendet që kërkojnë të ndërtojnë fuqinë e tyre ushtarake. Një tjetër temë e zakonshme në mesin e disa prej këtyre avionëve luftarakë të përmendur është se ata kanë qenë në prodhim për dekada, gjë që i jep besueshmëri rekordit të tyre luftarak.

“F-35 Lightning II” është një nga modelet më të reja që përdoret gjerësisht nga ushtritë botërore. “Lockheed Martin” ka prodhuar qindra nga këta avionë luftarakë gjatë dekadës së fundit dhe shumë vende të NATO-s kanë blerë këtë aeroplan me shumë funksione të gjeneratës së pestë. Një nga pikat kryesore të shitjes në “F-35” është shkathhtësia dhe aftësitë e tij të fshehta.

Vlen të theksohet se pjesa dërrmuese e kësaj liste përbëhet nga avionë luftarakë dhe helikopterë luftarakë. Ato priren të kenë më pak cisterna, transporte dhe avionë të misioneve speciale, sepse rolet e tyre janë të kufizuara, ndërsa avionët luftarakë janë më efektivë për të projektuar fuqinë.



F-5 Tiger II

- Avion aktiv: 611
- Avion me porosi: 0
- Lloji: Avion luftarak, avion stërvitor
- Vende të shquara: Brazili, Kili, Koreja e Jugut, Zvicra



F-35 Lightning II

- Avion aktiv: 716
- Avion me porosi: 2758
- Lloji: Avion luftarak, avion stërvitor
- Vende të shquara: Kanada, Izrael, Shtetet e Bashkuara



Mil Mi-17 Hip

- Avion aktiv: 765
- Avion me porosi: 65
- Lloji: Helikopter luftarak
- Vende të shquara: Bangladeshi, India, Venezuela



F-15 Eagle

- Avion aktiv: 1066
- Avion me porosi: 222
- Lloji: Avion luftarak, avion stërvitor
- Vende të shquara: Indonezia, Izraeli, Japonia, Shtetet e Bashkuara



AH-64 Apache

- Avion aktiv: 1233
- Avion me porosi: 324
- Lloji: Helikopter luftarak
- Vende të shquara: Greqia, India, Shtetet e Bashkuara



F-16 Fighting Falcon

- Avion aktiv: 2763
- Avion me porosi: 156
- Lloji: Avion luftarak, avion stërvitor
- Vende të shquara: Bahreini, Belgjika, Danimarka, Egjipti



S-70 Black Hawk

- Avion aktiv: 3909
- Avion me porosi: 806
- Lloji: helikopter luftarak, avion stërvitor
- Vende të shquara: Shtetet e Bashkuara, Arabia Saudite, Polonia



NH90 Caiman

- Avion aktiv: 446
- Avion me porosi: 147
- Lloji: Helikopter luftarak
- Vende të shquara: Australia, Franca, Holanda



Eurocopter H145

- Avion aktiv: 533
- Avion me porosi: 88
- Lloji: helikopter luftarak, avion stërvitor
- Vende të shquara: Shqipëria, Gjermania, Shtetet e Bashkuara



MD500 Defender

- Avion aktiv: 588
- Avion me porosi: 86
- Lloji: Helikopter luftarak
- Vende të shquara: Argjentina, Kolumbia, Koreja e Veriut

Gjeneral brigade Perlat Binaj, Komandant i Aviacionit Luftarak, nga ëndrra në realitet

Gjeneral Perlat Binaj, është një nga skënderbegasit që ka pasur një karrierë të suksesshme në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ai ka kryer detyra të rëndësishme, duke arritur gradën e lartë “gjeneral” dhe t’i besohet detyra e lartë e komandantit të Aviacionit Luftarak të Shqipërisë. Perlat Binaj lindi në Tiranë më 19 shkurt të vitit 1956, ku kreu me rezultate të mira shkollën tetëvjeçare. Në shtator të vitit 1971, atij i del e drejta e studimit për në Shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”. Ishte një dëshirë e tij që iu bë realitet. I përfundon studimet në korrik të vitit 1975 dhe renditet ndër maturantët e këtij viti që i mbaruan studimet me rezultate të larta. Pas pushimeve të post maturës, i nënshtrohet dhe një testimi të imët mjekësor dhe mbi bazë edhe të këtyre rezultateve, i jepet e drejta për të ndjekur studimet e larta në Shkollën e Lartë të Aviacionit, në qytetin bregdetar të Vlorës. Në shtator të vitit 1975 nis studimet në këtë shkollë dhe i përfundon ato në vjeshtën e vitit 1979, me rezultate të mira. Pas provimeve, diplomohet oficer aktiv dhe nis karrierën ushtarake si pilot ushtarak. Në kompletimin arsimor profesional të pilotit, Perlat Binaj, përfshihen dhe disa kualifikime të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë, ndër të cilat përmendim



kursin e lartë të fluturimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në gusht të vitit 1994 dhe kryerjen e studimeve në Kolegjin e Mbrojtjes në vitin 1995.


Karriera e pilotit për Perlat Binajn nis në Aeroportin e Kuçovës, ku pas shumë viteve fluturim dhe sukseseve që arriti në përmbyshjen e detyrave, në këtë njësi, atij i besohen dhe funksione të rëndësishme drejtimi e komandimi. Kështu, në periudhën 1979-1989, ai kreu detyrën e komandantit të katërshes, në Kuçovë. Në periudhën 1989-1992, ai kreu detyrën e zëvendëskomandantit për taktikën, qitjen dhe zbulimin. Nga Kuçova, në vitin 1992, ai transferohet në Tiranë, ku në periudhën nëntor 1992 - prill 1993, ishte zëvendëskomandant i Regjimentit të Aviacionit në Rinas. Nga kjo detyrë, në vitin 1993, atij i besohet detyra më e lartë në aviacionin shqiptar, ajo e komandantit të Komandës së Aviacionit me gradën e lartë “gjeneral brigade”. Këtë detyrë e ka kryer në periudhën prill 1993 - dhjetor 1995. Në këtë vit, me dekretin e Presidentit të Republikës, nr. 1576, datë 09.08.1006, nxirret në rezervë.

Gjatë karrierës së gjatë në Forcat e Armatosura, gjeneral Perlat Binaj është vlerësuar me disa urdhra e dekorata shtetërore.

Tahir Hoxha, skënderbegasi që erdhi nga lufta e bëri emër në Flotën Luftarake Detare të Shqipërisë

Tahir Hoxha erdhi në shkollën “Skënderbej” direkt nga lufta, në moshën 17 vjeçare, kreu disa akademi në Bashkimin Sovjetik e gjatë punës në dekada, la emër në detarinë shqiptare.

Tahir Hoxha u lind në Tërbaç të Vlorës, më 5 maj të vitit 1928. Pas shkollës fillore në vendlindje, në vitin 1941, Tahiri nis vitin e parë në Shkollën Tregtare të Vlorës. Ai u strehua tek e ëma e Halim Xhelos, që ishte teza e vëllait të tij të madh, në një shtëpi me dy dhoma. Në një dhomë rrinin këta, ndërsa në dhomën tjetër Arif Hasko dhe Hito Çako. Në këtë shkollë, që u bë bazë e rëndësishme e përhapjes së lëvizjes për rezistencë kundër pushtuesit, ai bëhet pjesë e kësaj lëvizjeje të rëndësishme. Pas “Operacionit të dimrit”, Tahiri, me një grup të rinjsh të tjerë komunistë, bëhet partizan i Brigadës V Sulmuese. Në moshën 16 vjeçare, në nëntor të vitit 1944, pranohet anëtar i Partisë Komuniste dhe në muajin shkurt të vitit 1945, emërohet zëvendës komisar kompanie në këtë brigadë. Në vitin 1945, Tahir Hoxha, është ndër skënderbegasit e parë që erdhën nga lufta dhe nisi studimet në shkollën “Skënderbej” që u hap me urdhër të veçantë të qeverisë së re shqiptare, më 28 mars 1945. Shkolla “Skënderbej”, në vitin e parë të hapjes së saj, kishte specifike në mësimdhënie, pasi skënderbegasit e ardhur nga lufta kishin arsim të ndryshëm e jo pak ishin dhe analfabet. Shkollën “Skënderbej” e përfundon në vitin 1948. Në shkurt të vitit 1948, i del e drejta e studimit për inxhinieri navale në Leningrad (San-Petërburg) të Bashkimit Sovjetik. Në dhjetor të vitit 1953 diplomohet në këtë akademi ushtarake dhe në janar të vitit 1955 kthehet në Shqipëri. Emërohet inxhinier mekanik në katersiluruesit në Sazan. Në qershor të vitit 1954 transferohet në Durrës pranë Komandës së Mbrojtjes Bregdetare me detyrën e shefit elektro-mekanik të Korpusit Bregdetar. Më 1 tetor të vitit 1955 nis përsëri studimet në Akademinë Ushtarake të Ndërtimit dhe Armatimit të Anijeve në Leningrad të ish-Bashkimit Sovjetik. Studimet në këtë akademi ai i mbaroi me medalje të artë. Kur kthehet në Shqipëri e emërojnë shef elektro-mekanik të Flotës Luftarake Detare. Në vazhdim ai ka kryer detyra të rëndësishme në komandën e FLD-së dhe së fundi, edhe pedagog e drejtues në Shkollën e Lartë të Marinës Luftarake në Vlorë, e cila u çel më 1 tetor të vitit 1961. Si inxhinier, drejtues e pedagog, ai ka lënë emër të mirë tek kolegët dhe tek të gjithë ata me të cilët punoi. Ja disa vlerësime... Gëzim Isufi: “...Tahiri, mbi të gjitha, ishte një njeri me zemër të madhe. Njëpër grimca episodesh, jeta e tij më shfaqet herë partizan 15-vjeçar, që përleshje me nazistët, herë kadet në bankat e shkollës ‘Skënderbej’, herë student në Akademinë Navale të Rosisë, herë kryeinxhinier i FLD-së të Shqipërisë, herë



drejtore i Uzinës Ushtarake të Flotës... i afruan edhe poste të tjerë, madje shumë të rëndësishëm, por ai thoshte me modesti: “Më pëlqen të jem gjithmonë një inxhinier i lidhur me detin”.

Fejzi Rrokaj (Koleg i tij): “...Tahir Hoxha asnjëherë nuk kërkoi dhe as pretendoi për një lavdi të pamërituar, por çau në jetë me modesti, i matur, i dashur dhe i vendosur për të arritur qëllimet e tij fisnike... Ai ka qenë dhe mbetet një shembull i lartë i urtësisë, i figurës së pastër, i pa kompromentuar. Ka qenë kundër prepotencës,

arrogancës, hakmarrjes...”. Kasëm Spahiu (Kryetar i Shoqatës ‘Detaria’, Vlorë): “...Tahir Hoxha, bashkë me disa shokë të tjerë si, Qemal Hysi, Izet Velçani, Shezai Osmëni, Seit Jonuzaj etj., kanë kontribuar në krijimin e Flotës Luftarake Detare, e ne të rinjtë i kemi quajtur ‘Kollonkat e Flotës’. ...Tahiri, edhe pasi doli në pension, ka një meritë tjetër, krijoi Shoqatën e Detarisë në Vlorë, të cilën e drejtoi mbi 5 vjet...”.

Skënderbegas ndër vite...



Shqiptari mund të lërë pas vendin e tij, por asnjëherë zakonet e gdhendura fort në sjelljen e përditshme. Ajo që mrekullon në lidhje me kulturën e ndryshme të popujve është sesi disa sjellje të një populli, i duken marrëzi një tjetri, dhe jo gjithmonë me një konotacion negativ. Të huajt që vizitojnë Shqipërinë dhe jetojnë për aq kohë, mjaftueshëm sa për të vënë re zakonet tona, shprehin shpesh habi mbi disa sjellje tonat, të drejta ose jo, por që tregojnë shumë mbi mentalitetin dhe grindën që na vlon në gjak, p.sh..

Të folurit e shumë gjuhëve

- Shqiptarët janë në gjendje të flasin shumë gjuhë të huaja.
- Shqiptarët janë shumë të lidhur me muzikën tradicionale. Shumë turistë që vizitojnë vendin tonë bien në dashuri me ritmet e muzikës sonë popullore dhe madje tentojnë të mësojnë vallet tradicionale. Iu bën shumë përshtypje fakti sesi e kemi ruajtur me shumë lehtësi prezencën e artit folklorik në përditshmërinë tonë. Natyrisht, si mund të harrohen serenatat? E pamundur!
- Hedhja e parave duke kërcyer në dasma, në këtë pikë kanë të drejtë të çuditën. Të huajt gjykojnë se hedhja e parave në tokë, të cilësdo monedhë qofshin ato, tregon mungesë respekti për punën e bërë për t'i fituar, por pak prej tyre e njohin ndjesinë e të rënit në sy të fisit, tezeve dhe hallave, minimalisht një herë në vit. Kur të jepet mundësia, pse mos ta shfrytëzojmë?
- Pellushët e varur në shtëpitë e reja, ky është një zakon disi i frikshëm. Por nëse eksploron në periferi të qyteteve ose në fshatrat shqiptare, do të shohësh masivisht kukulla, arusha e lodra të ndryshme të dëmtuara nga shiu e era, në majën e terracave të shtëpive.
- Kafeja pihet në çdo orar, po si mund t'i caktosh një orar kafesë? Kafeja e gazetës së mëngjesit, kafeja e çlodhjes pas pune, kafeja e pasdites në lagje. Domethënë, kush ia ka parë të keqen kafesë? Kurioziteti i të huajve qëndron në faktin se ku e gjejmë kohën për kaq shumë kafe. (Normalisht, s'kemi ndërmend ta nxjerrim këtë sekret).
- Grindja për të paguar në lokal, tradita do të mbijetojë në shekuj. Unë të paktën do vazhdoj të kontribuoj për ta mbajtur gjallë këtë normë të sherrit të qerasjes, sepse është momenti më argëtues i takimit me një mik a mikeshë. Më mungoi shumë ky çast sublim në kohën që jetova jashtë Shqipërisë dhe vazhdimisht ndahej fatura ekzaktësisht 50 me 50, deri në qindarkën e fundit. (Epo edhe ashtu s'bëhet!).
- Kanuni i Lekë Dukagjinit dhe gjakmarrja, zbatim i Kanunit është një plagë e shoqërisë sonë që përbën një pistë kërkimi për shumë reporterë të huaj në kërkim të sjelljeve të pazakonta të popujve të vegjël dhe në zhvillim e sipër. Personalisht mendoj që ende nuk është realizuar dokumentari më i mirë i praktikimit të Kanunit në ditët e sotme në Veriun e vendit tonë dhe ende ka shumë të pathëna.
- Martesa me 'mblesëri', duket absurde në vitin 2024, ende ndodh në shumë zona rurale, ku të rinjtë prezantohen nga familjet e tyre dhe mund ta vazhdojnë njohjen me njëri-tjetrin vetëm me miratimin e familjarëve. Sipas kohës, edhe kuvendi! (Dikur nuk ekzistonin rrjetet sociale për t'u njohur me gjysmën tjetër, kështu që njëra nga hallat duhet ta merrte mundimin për ta kryer këtë mision).
- Të takosh fillimisht njeriun më të madh në moshë, nëse je në një festë familjare, do të duhet të bësh respektin siç duhet, të takosh sipas radhës nga më i vjetri tek më i riu të zotët e shtëpisë. Dikur ka qenë shumë e thjeshtë, sepse njerëzit uleshin në karrige apo divane, sipas rëndësisë ose moshës së tyre dhe mjaftojte t'i merrje me radhë nga e majta në të djathtë, por sot si i bëhet? (T'i takojmë sipas gjatësisë?) Pyes...

Zakonet e gdhendura në sjelljen e përditshme të shqiptarëve

- Të luten të rrih kur u shkon për vizitë, ka gjithnjë 3 tentativa për ta bindur mikun të rrijë më tepër në shtëpi, përpara se të dorëzohesh dhe ta lësh të shkojë. Imagjinoj fytyrën e një gjermani teksa sheh një shqiptar kur përpiket të largohet në punën e tij, por xhaxhai kurrsesi nuk pranon ta largojë pa ngrënë edhe darkën. Eh ç' dashuri!
- Mosrespektimi i radhës, jemi të vetëdijshëm për këtë zakon aspak perëndimor! Por dinamika e jetës na shtyn të biem në mëkat e t'i thyejmë herë pas here normat e sjelljes në publik. Radha nuk është vërtet gjëja jonë. Kalojmë të pika tjetër!
- Sa e ke rrogën? Natyrisht nuk e kursejmë këtë pyetje as për të huajt që vizitojnë vendin tonë, edhe pse hapin sytë me këtë pyetje. 'Ku punon? Si e gjeje punën? A keni pas punë? A të del rroga? Janë veç pyetjet bazike për të bërë një mik të ri në Shqipëri. Zor se do jetë i huaj, sepse me siguri nuk do të të flasë më, pas kësaj njohjeje të thellë.
- Valle dhe aheng për çdo gëzim. Kushërirat e mia në Amerikë më tregonin njëherë habinë e mikeve të tyre amerikane që pyesnin sesi është e mundur që Shqiptarët kanë një festë çdo fundjavë: ditëlindje, dita e emrit, fejesa, lindja e fëmijës, synetllëqe, dasma, përvjetorë martese e të tjera plot. Mos të lëntë Zoti pa festa!
- Dasmat deri në 6 të mëngjesit, në një dasmë italiane, ku kam qenë e ftuar, darka filloi në orën 6 pasdite dhe përfundoi diku rreth mesnatës. Kështu të gjithë mund të pushonin dhe të ishin gati për ditën e re, sidomos kur është e hënë. Por jo, nuk është mënyra jonë. Shprehja tipike që përdoret në këto raste është '1 martohet, 100 tërbohen', në kuptimin më dashamirës të fjalës. Dhe sigurohem që tërbimi të lejë pasoja të mëtejshme.
- Format e çuditshme të komplimenteve, 'që nga ngrënia e syve', 'zembrës' e me radhë e deri tek 'vdeksha për ty', një i huaj do të pyesë gjithmonë se çfarë kuptimi ka kjo formë komplimentimi dhe pse është kaq kanibalo-tragjike. Por ne, pikërisht për këto fraza, shpikëm mënyrën dëshirore të foljes, ndaj do vazhdojmë t'i përdorim.
- Simboli i shqiponjës me dy duart. Ky simbol i bërë shpesh në foto apo klipe është pasaporta e vjedhjes së zemrës së shqiptarëve. Nëse e bën një i huaj, dihet, është njëri nga ne.
- Tatuazh i shqiponjës ose varëse me shqiponjë. Simbolet kombëtare janë të shenjta për ne dhe jemi gati t'i gdhendim në trup, ose minimalisht në flori. Kjo tingëllon pak dramatike për të huajt që nuk

kanë domosdoshmërisht atë lidhje identifikuese me origjinën sikurse ne shqiptarët.

- Mbatja e rakisë në shishe plastike uji. Sugjeroj që mbi çdo shishe raki të vendosen disa etiketa të kuqe me shkronja të mëdha, ku të paralajmërohet kujdes, jo vetëm për ata që kujtojnë një moment se është ujë, por edhe ata që me vetëdije të plotë e pinë rakinë si ujë.
- Të pish raki për mëngjes, kafenetë e lagjes janë mikpritësit e parë të burrave pijedashës shqiptarë, të cilët ngrohën kordat e zërit që në mëngjes, për t'u prononcuar më pas për çështjet me rëndësi politike. Zakoni është i rëndësishëm por të huajt që zgjohen me kafe e briosh, zor se mund ta kuptojnë.
- Kur zë lemza, të kujton dikush, njëherë që e mëson këtë sekret, pak rëndësi ka se nga cili vend i botës së madhe je, por do të kujtohesh gjithnjë se diku, dikush po mendon për ty dhe kjo është shumë romantike.
- Shumë bukë me gjithçka, të huajt duhet të kuptojnë që buka është eliksiri i jetës për shqiptarët, sidomos buka e bërë në shtëpi, të cilën nënat tona e qajnë. Çdo ushqim tjetër shoqërohet me bukë, sepse kështu na pëlqen....
- Të folurit me zë të lartë në avion, autobus, rrugë..., etika e sjelljes në publik ka disa krisje që në të ardhmen me siguri do të reduktohen. Ndërkohë, le t'ia bëjmë me dije gjithë udhëtarëve që ka shqiptarë në avion.
- Ngritja në këmbë ende pa u ulur avioni, apo ende pa ndaluar autobuzi. Po, jemi njerëz që ngutemi dhe na mungon durimi. Dhe po, është dikush që na pret tek salla e mbërritjes së aeroportit, ndaj nuk do ta lëmë të presë. U shpjegova qartë?!
- Nënati i trajtojnë djemtë si fëmijë deri 30 vjeç, trajtimi i djemve si mbretër të shtëpisë, që kanë nevojë ta kenë çdo gjë gati në kohën dhe vendin e duhur është një nga gabimet më të mëdha e të paqëllimta të nënave shqiptare, që shpesh nuk duan të kuptojnë që djemtë janë të aftë për të gatuar dhe pastruar po aq sa edhe vajzat.
- Babi e thërret fëmijën babi dhe mami e thërret fëmijën mami, është krejt normale që një nënë shqiptare t'i thotë fëmijës: "Hajde mami në shtëpi se është dreka gati". Nuk bën aspak sens ndërsa ia përkthejmë këtë një të huaji, që thjesht dorëzohet për të kuptuar sesi funksionon komunikimi ynë me njëri-tjetrin.

E gjitha sa më sipër është një këndvështrim i imi. Gjatë itinerarit të jetës sime takova këtë realitet.



Përgjatë vitit 2024, vijojnë aplikimet për pranimin e kandidatëve për:

- Ushtarë/ Detarë aktivë përgjatë tre periudhave të rekrutimit (Prill, Shtator, Dhjetor)
- Studime Ushtarake në Akademinë e Forcave të Armatosura
- Studime Ushtarake në Akademinë “West Point” në SHBA
- Studime Ushtarake në Itali
- Studime Ushtarake në Turqi
- Studime Ushtarake në Greqi
- Studime Ushtarake në Mbretërinë e Bashkuar